PLANI VENDOR PËR PËRSHTATJEN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE 2027-2036

Përmbajtja

Lista e shkurtesave..... 4

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5
1. Hyrje 6
1.1 Rëndësia e ndryshimeve klimatike 7
1.2 Funksionet e Planit Vendor të Përshtatjes 7
1.3 Baza ligjore 7
2. Rrethanat vendore 8
2.1 Tiparet gjeografike dhe territoriale 8
2.1.1 Tiparet vendore 8
2.1.2 Zonat urbane 9
2.1.3 Tiparet ekologjike 12
2.2 Ekonomia dhe sektorët prioritarë 15
2.2.1 Bazat e ekonomisë 15
2.2.2 Treguesit ekonomikë 16
2.3 Kushtet socio-ekonomike dhe grupet e cenueshme 17
2.3.1 Varfëria dhe përjashtimi social 17
2.3.2 Treguesit shëndetësorë 19
2.3.3 Treguesit arsimorë 20
2.4 Profilet e sektorëve prioritarë 21
2.4.1 Bujqësia 21
2.4.2 Zhvillimi urban 22
2.4.3 Turizmi 23
2.4.4 Energjia 24
2.4.5 Transporti 25
3. Qeverisja dhe kuadri rregullator 25
3.1 Profili i qeverisjes në Patos 26
3.2 Objekti i Planit Vendor të Përshtatjes 27
3.3 Lidhjet me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe kuadrin e planifikimit 28
4. Procesi i hartimit dhe angazhimi i palëve të interesit 29
4.1 Organizimi i nevojshëm institucional për procesin e PVP-së 29
4.2 Proceset e angazhimit të palëve të interesit 30

DRAFT

4.3 Informacione/organizime institucionale shtesë të nevojshme për procesin e PVP-së 31
5. Informacioni klimatik dhe rreziqet kryesore 32
5.1 Përshkrim i detajuar i rreziqeve klimatike për Bashkinë Patos 33
5.1.1 Përmbytjet dhe reshjet intensive 33
5.1.2 Thatësirat dhe mungesa e ujit 34
5.1.3 Valët e të nxehtit dhe temperaturat ekstreme 34
5.1.4 Zjarret në pyje, kullota dhe territore bujqësore 34
5.1.5 Rrëshqitjet e tokës dhe erozioni 35
5.1.6 Ndikimet klimatike mbi cilësinë e ujit, tokës dhe ajrit 35
5.1.7 Tabela e indikatorëve për monitorimin e rreziqeve klimatike 35
5.2 Informacion mbi klimën 36
5.2.1 Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri 36
5.2.2 Parashikimet klimatike për të ardhmen për Shqipërinë 37
5.2.3 Parashikimet e reshjeve 37
6. Vlerësimi i riskut dhe cenueshmërisë 38
7. Analiza sektoriale 40
7.0 Metodologjia me tre hapa për analizën sektoriale 41
7.1 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar 42
7.2 Infrastruktura 43
7.3 Bujqësia, uji dhe ekonomia vendore 44
7.4 Mjedisi natyror, pyjet dhe biodiversiteti 45
7.5 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë 46
8. Plani Vendor i Veprimit 2027-2036 47
9. Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi 49
10. Tabelat e masave prioritare sipas sektorëve 50
10.1 Masat për periudhën 2027-2036 50
11. Shtojcat orientuese 56
Shtojca 1. Procesi i konsultimit dhe angazhimit të palëve të interesit 56
Shtojca 2. Integrimi i vlerësimeve të cenueshmërisë dhe riskut 57
Shtojca 3. Kriteret e pikëzimit të riskut 57

DRAFT

Shtojca 4. Lista orientuese e masave të përshtatjes sipas sektorëve 57
Shtojca 5. Metodologjia dhe kriteret për prioritizimin e masave të përshtatjes..... 58
Shtojca 6 Matrica e përgjegjësive..... 58
Shtojca 7 Hartat bazë..... 59
12. Referenca kryesore 73

DRAFT

Lista e shkurtesave

- PNK – Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike VKM – Vendimi i Këshillit të Ministrave
- U&K – Ujitje dhe Kullim
- PINS – Plani i Integruar Ndërsektorial INSTAT – Instituti Kombëtar i Statistikave
- PVP – Plani Vendor i Përshtatjes
- NJQV – Njësitë e Qeverisjes Vendore

- PVZH – Plani i Përgjithshëm Vendor i Zhvillimit
- PKP – Plani Kombëtar i Përshtatjes
- AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- AREB - Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
- ARZM – Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura
- PVEQ – Plani Bashkiak i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme
- PLUQ – Plani i Lëvizshmërisë Urbane të Qëndrueshme
- UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
- KKKBNK – Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

DRAFT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bashkia Patos, si pjesë e territorit të Shqipërisë po përballet me ndikime gjithnjë e më të dukshme të ndryshimeve klimatike, të cilat manifestohen përmes rritjes së temperaturave, periudhave më të gjata të thatësirës, rritjes së frekuencës së reshjeve intensive, përmbytjeve lokale, zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe proceseve të erozionit dhe rrëshqitjeve të dherave.

Karakteristikat territoriale të Patosit, të kombinuara me rëndësinë e sektorit bujqësor, praninë e sistemit të ujitjes dhe kullimit, zonat kodrinore, rrjetin e infrastrukturës publike dhe aktivitetin hidrokarbur, krijojnë një nivel të lartë ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore.

Vlerësimi i kryer në kuadër të këtij Plani Vendor të Përshtatjes identifikon pesë rreziqe prioritare:

1. Përmbytjet dhe reshjet intensive.
2. Thatësirat dhe mungesa e ujit.
3. Valët e të nxehtit.
4. Zjarret në pyje, kullota dhe toka bujqësore.
5. Ndotja mjedisore dhe risku teknologjik në zonat e ndikuara nga aktiviteti hidrokarbur.

Sektorët më të cenueshëm rezultojnë të jenë bujqësia, infrastruktura publike, shëndeti publik, burimet ujore, ekonomia vendore dhe ekosistemet natyrore.

Vizioni i Planit Vendor të Përshtatjes është:

"Një Bashki Patos e sigurt, reziliente dhe e aftë për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike, duke mbrojtur qytetarët, ekonominë, burimet natyrore dhe infrastrukturën publike."

Për arritjen e këtij vizioni janë përcaktuar pesë objektiva strategjikë:

- Forcimi i sigurisë ndaj përmbytjeve.
- Rritja e sigurisë ujore dhe reziliencës së bujqësisë.
- Mbrojtja e shëndetit publik nga rreziqet klimatike.
- Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe financiare për përshtatje.

DRAFT

1. Hyrje

Ky dokument paraqet Planin Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike për Bashkinë Patos për periudhën 2027-2036. Plani synon të forcojë aftësinë ripërtëritëse të territorit, komunitetit, ekonomisë vendore, infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndaj ndikimeve aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike.

Plani është ndërtuar bazuar në Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036, ku ndërthuren risqet klimatike, përmbytjet, thatësirat, zjarret, rrëshqitjet, risku

teknologjik i lidhur me aktivitetin hidrokarbur dhe nevoja për zhvillim të qëndrueshëm urban, bujqësor dhe energjetik.

1.1 Rëndësia e ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike po rrisin shpeshtësinë dhe intensitetin e ngjarjeve ekstreme, si reshjet e dendura, përmbytjet, periudhat e gjata të thatësirës, valët e të nxehtit dhe zjarret në territor. Në Bashkinë Patos këto ndikime lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e banorëve, funksionimin e infrastrukturës, prodhimin bujqësor, cilësinë e mjedisit dhe shërbimet publike. Popullsia kryesisht rurale, është shumë e ndjeshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, ku reshjet ekstreme shpesh sjellin përmbytje, ndërsa jetesa e bazuar në bujqësi dhe disponueshmëria e ujit të pijshëm kërcënohen gjatë thatësirave.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nuk është vetëm çështje mjedisore, por edhe çështje zhvillimi ekonomik, mbrojtjeje civile, shëndeti publik, planifikimi territorial dhe sigurie energjetike. Për këtë arsye, plani kërkon integrimin e riskut klimatik në buxhetim, investime, zhvillim urban, bujqësi, ujitje e kullim, menaxhim pyjesh, shëndetësi, arsim dhe komunikim publik.

1.2 Funksionet e Planit Vendor të Përshtatjes

Plani Vendor i Përshtatjes shërben si instrument drejtues për identifikimin, prioritizimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e masave që zvogëlojnë cenueshmërinë e Bashkisë Patos ndaj ndryshimeve klimatike. Ai mbështet vendimmarrjen e bazuar në prova, forcon koordinimin ndërinstitucional dhe krijon bazën për aplikime në fonde kombëtare e ndërkombëtare. PVP-të hartohen në mënyrë që bashkia të mund ta monitorojë dhe rishikojë atë rregullisht, si dhe ta përditësojë herë pas here bazuar në të dhëna dhe parashikime klimatike të reja dhe/ose më cilësore, si dhe në informacione të tjera të dobishme për procesin e planifikimit. PVP-ja duhet të identifikojë vazhdimisht mangësitë në kapacitete dhe përshtatje, si dhe të planifikojë trajtimin e tyre. Gjithashtu, ajo duhet të integrojë në proces pikëpamjen gjinore me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në proceset vendimmarrëse, si dhe në zbatimin e veprimtarive të përshtatjes. Për më tepër, duhet të sigurohet që procesi i PVP-së dhe veprimtaritë e tij të mos përkeqësojnë pabarazitë gjinore. Këto plane mund të rezultojnë në përshtatje më të mirë dhe në komunitete me qëndrueshmëri më të mirë.

1.3 Baza ligjore

Hartimi i këtij plani mbështetet në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, i ndryshuar dhe VKM nr. 432, datë

DRAFT

10.06.2026 “ Për Miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036”.

2. Rrethanat vendore

2.1 Tiparet gjeografike dhe territoriale

Bashkia Patos ndodhet në Qarkun Fier dhe përfshin qytetin e Patosit dhe njësitë administrative Ruzhdie dhe Zharrëz. Territori është i lidhur ngushtë me zonën fushore-kodrinore të Myzeqesë dhe Mallakastrës, me aktivitet bujqësor, vendbanime urbane e rurale, zona kodrinore të ekspozuara ndaj erozionit dhe rrëshqitjeve, si dhe zona të ndikuara historikisht nga industria hidrokarbure.

Territori i bashkisë ka rëndësi të veçantë për shkak të pozicionit pranë aksit ekonomik Fier-Patos-Ballsh, afërsisë me lumin Seman dhe zonat bujqësore, si dhe pranisë së aktiviteteve industriale e hidrokarbure që rrisin kompleksitetin e menaxhimit të riskut mjedisor dhe teknologjik.



2.1.1 Tiparet vendore

Bashkia Patos është një njësi vendore e Qarkut Fier, me qendër qytetin Patos dhe njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdie. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Bashkia Patos, territori ka sipërfaqe rreth 82.5 km² dhe përfshin qytetin Patos, si dhe fshatrat Dukas, Banaj, Margëlliç, Kuqar, Rerës, Rusinjë, Grizë-Lënginas, Zharrës, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë, Ruzhdie, Gjinoqarë, Siqecë, Drenie dhe Kasnicë. Pozicioni gjeografik pranë qytetit të

Fierit, në ndërthurje të zonës fushore të Myzeqesë me kodrat e Mallakastrës së poshtme, e bën Patosin një territor me karakter të përzier urban, rural, bujqësor dhe industrial.

Të dhënat e Censit 2023 tregojnë se popullsia banuese e Bashkisë Patos është 18,227 banorë, ndërsa sipas ndarjes administrative njësia Patos ka peshën më të madhe të popullsisë, e ndjekur nga Zharrëza dhe Ruzhdia. Kjo strukturë tregon përqendrim më të lartë të banorëve në qendrën urbane dhe në zonat përreth saj, ndërkohë që njësitë rurale kanë varësi më të madhe nga bujqësia, blegtoria, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, rrugët vendore dhe shërbimet bazë. Në kontekstin e përshtatjes klimatike, kjo shpërndarje kërkon masa të diferencuara për zonat urbane, fshatrat fushorë të ekspozuar ndaj përmbytjeve dhe zonat kodrinore të ekspozuara ndaj erozionit, rrëshqitjeve dhe zjarreve.

2.1.2 Zonat urbane

Përdorimi hapësinor dhe demografia. Zona urbane kryesore e Bashkisë Patos përqendrohet në qytetin Patos dhe në vendbanimet përreth tij, ku ndodhen pjesa më e madhe e shërbimeve administrative, arsimore, shëndetësore, tregtare dhe të transportit. Sipas Censit 2023, popullsia banuese e bashkisë është 18,227 banorë, me përqendrim të konsiderueshëm në njësinë Patos. Ky përqendrim rrit ekspozimin e popullsisë dhe të shërbimeve publike ndaj përmbytjeve urbane, valëve të të nxehtit, ndërprerjeve të ujit ose energjisë dhe bllokimit të qarkullimit gjatë ngjarjeve ekstreme. Prandaj, menaxhimi i hapësirave publike, rrugëve urbane, kanalizimeve, ujësjellësit, ndriçimit, gjelbërimit dhe shërbimeve të pastrimit duhet të vlerësohet jo vetëm si shërbim rutinë, por si masë parandaluese për uljen e riskut klimatik.

DRAFT



Infrastruktura urbane. Infrastruktura urbane e Patosit përfshin rrugët kryesore dhe dytësore, trotuaret, ndriçimin publik, hapësirat e gjelbra, objektet arsimore e shëndetësore, rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve dhe sistemin e kullimit urban. Në dokumentet vendore të zhvillimit dhe buxhetimit theksohet nevoja për përmirësimin e rrugëve, kanalizimeve, hapësirave publike dhe shërbimeve bazë.



Furnizimi me ujë dhe kanalizimet. Furnizimi me ujë, kanalizimet dhe largimi i ujërave atmosferike janë elemente kritike për përshtatjen klimatike, sepse lidhen drejtpërdrejt me dy rreziqet kryesore për Patosin: mungesën e ujit gjatë thatësirave dhe përmbytjet gjatë reshjeve intensive. Thatësirat dhe temperaturat e larta rrisin kërkesën për ujë të pijshëm dhe ujë për përdorime familjare e ekonomike, ndërsa reshjet intensive shtojnë presionin mbi rrjetin e kanalizimeve dhe kanalet kulluese. Nëse këto sisteme nuk mirëmbahen, risku klimatik mund të shndërrohet në problem shëndetësor, ndotje të ujërave, dëmtim të banesave dhe ndërprerje të shërbimeve. Në zonat urbane dhe periurbane të Patosit kërkohet mirëmbajtje e vazhdueshme e rrjetit, reduktim i humbjeve, pastrim periodik i pusetave dhe kanaleve, si dhe koordinim më i mirë ndërmjet shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, strukturave të kullimit dhe emergjencave civile.

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos



Mbetjet urbane. Menaxhimi i mbetjeve urbane është një nga shërbimet bazë që lidhet drejtpërdrejt me shëndetin publik, cilësinë e mjedisit dhe reziliencën ndaj përmbytjeve. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Patos 2026-2030 synon përmirësimin e grumbullimit, transportit, minimizimit, riciklimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit. Në kontekst klimatik, mbetjet e hedhura në mënyrë të pakontrolluar ose në afërsi të kanaleve mund të bllokojnë rrjedhën e ujërave, të shtojnë përmbytjet lokale dhe të shkaktojnë ndotje sekondare gjatë reshjeve të dendura. Për këtë arsye, pastrimi i pikave problematike, ndarja në burim, kontrolli i mbetjeve inerte dhe edukimi mjedisor duhet të jenë pjesë e masave të përshtatjes.

2.1.3 Tiparet ekologjike

Peizazhi ujor. Peizazhi ujor i Bashkisë Patos lidhet me praninë e kanaleve ujitëse e kulluese, rezervuarëve, ujërave sipërfaqësore dhe afërsinë me lumin Seman në zonën më të gjerë funksionale. Ky sistem është njëkohësisht aset zhvillimi dhe burim cenueshmërie klimatike: gjatë reshjeve intensive mund të mbingarkohet dhe të shkaktojë përmbytje, ndërsa gjatë thatësirave mund të mos sigurojë ujë të mjaftueshëm për bujqësinë dhe përdorime të tjera



Ekonomitë pyjore dhe zonat kodrinore. Zonat kodrinore dhe sipërfaqet pyjore të Bashkisë Patos, veçanërisht në drejtim të Ruzhdies, Drenies, Gjinoqarës dhe zonave të tjera me terren të thyer,

kanë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e tokës nga erozioni, stabilizimin e shpateve, ruajtjen e biodiversitetit dhe zbutjen e temperaturave lokale. Në kushtet e ndryshimeve klimatike, këto funksione bëhen edhe më të rëndësishme, sepse degradimi i mbulesës bimore rrit shpejtësinë e rrjedhjes së ujërave gjatë reshjeve të dendura, shton sedimentimin e kanaleve dhe rrit rrezikun e rrëshqitjeve në zonat kodrinore. Nga ana tjetër, thatësira dhe temperaturat e larta rrisin ndezshmërinë e bimësisë dhe mundësinë e zjarreve në pyje, kullota dhe toka bujqësore. Për këtë arsye, pyjet dhe korridoret e gjelbra duhet të trajtohen si infrastrukturë natyrore për përshtatjen klimatike, duke përfshirë ripyllëzim me specie vendase, mirëmbajtje të rrugëve pyjore, krijim brezash kundër zjarrit dhe masa për parandalimin e rrëshqitjeve.



Cilësia e mjedisit dhe biodiversiteti. Patosi ka një profil ekologjik të ndikuar nga ndërthurja e bujqësisë, vendbanimeve, rrjetit ujor, zonave kodrinore dhe aktivitetit hidrokarbur. Raportet vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe vlerësimin strategjik mjedisor theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së ujit, tokës, ajrit, peizazhit dhe shëndetit të popullsisë. Në kushtet e ndryshimeve klimatike, ndotja ekzistuese mund të shpërndahet më lehtë përmes ujërave sipërfaqësore gjatë përmbytjeve, të përqendrohet gjatë thatësirës ose të përkeqësohet nga zjarret dhe pluhuri gjatë periudhave të nxehta. Kjo do të thotë se risku klimatik në Patos nuk kufizohet vetëm te dëmet fizike nga përmbytjet, zjarret apo rrëshqitjet, por përfshin edhe rritjen e ekspozimit të komunitetit ndaj ndotjes dhe humbjen e shërbimeve ekosistemike që mbrojnë territorin. Prandaj, monitorimi i

cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës, rehabilitimi i zonave të degraduara, kontrolli i mbetjeve dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbra janë masa të rëndësishme për forcimin e qëndrueshmërisë ekologjike të bashkisë.



2.2 Ekonomia dhe sektorët prioritarë

Ekonomia vendore e Patosit mbështetet në shërbime, bujqësi, blegtori, tregti, aktivitete të vogla prodhuese dhe ndikimin e sektorit hidrokarbur. Ndryshimet klimatike ndikojnë në secilin prej këtyre sektorëve përmes thatësirave, rritjes së kostove të energjisë, dëmtimit të tokës, përmbytjeve, presionit mbi ujitjen dhe rritjes së riskut të ndërprerjeve në infrastrukturë.

2.2.1 Bazat e ekonomisë

Baza ekonomike e Bashkisë Patos është formuar historikisht nga sektori hidrokarbur, veçanërisht nga afërsia me basenin naftëmbajtës Patos-Marinzë, i cili ka ndikuar në zhvillimin urban, punësimin, strukturën profesionale dhe identitetin ekonomik të zonës. Megjithatë, roli i drejtpërdrejtë i këtij sektori në punësimin vendor është ulur krahasuar me periudhat e mëparshme, ndërsa ekonomia lokale është diversifikuar drejt bujqësisë, shërbimeve, tregtisë dhe aktiviteteve të vogla prodhuese.

Bujqësia dhe blegtoria përbëjnë një shtyllë të rëndësishme të ekonomisë vendore, sidomos në njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdie dhe në fshatrat përreth qytetit. Territori fushor-kodrinor favorizon prodhimin bujqësor, kultivimin e ullirit, vreshtarisë, drufrutorëve, perimeve dhe kulturave të arave, ndërsa blegtoria mbështet të ardhurat e familjeve rurale. Kultivimi i ullirit dhe përpunimi ose tregtimi i nënprodukteve të tij kanë rëndësi të veçantë në zonat kodrinore, ku relievi dhe tradita bujqësore krijojnë mundësi për ekonomi familjare, agro-përpunim dhe tregje vendore.

Nga këndvështrimi i përshtatjes klimatike, baza ekonomike e Patosit është e ndjeshme ndaj disa rreziqeve të ndërlidhura: thatësirat ulin disponueshmërinë e ujit për bujqësi dhe rrisin kostot e prodhimit; reshjet intensive dhe përmbytjet dëmtojnë tokat, rrugët dhe kanalet; zjarret prekin pyjet, kullotat dhe sipërfaqet bujqësore; ndërsa ndotja e trashëguar ose aktuale nga aktivitetet hidrokarbure mund të përkeqësohet gjatë ngjarjeve ekstreme. Për këtë arsye, zhvillimi ekonomik vendor duhet të orientohet drejt diversifikimit të të ardhurave, bujqësisë reziliente, mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes e kullimit, mbështetjes së biznesit të vogël dhe rehabilitimit të zonave të degraduara.

2.2.2 Treguesit ekonomikë

Treguesit ekonomikë për Bashkinë Patos duhet të lexohen në lidhje me strukturën demografike, përdorimin e tokës, profilin rural-urban dhe varësinë nga sektorët e ndjeshëm ndaj klimës. Sipas Censit 2023, popullsia banuese e bashkisë është 18,227 banorë, ndërsa të dhënat vendore të regjistrit civil raportojnë një popullsi më të lartë administrative. Ky dallim tregon rëndësinë e përdorimit të dy bazave të të dhënave gjatë planifikimit: popullsia banuese për vlerësimin real të kërkesës për shërbime dhe popullsia e regjistruar për planifikimin administrativ, buxhetor dhe të emergjencave.

Treguesi	Gjendja kryesore	Rëndësia për përshtatjen klimatike
Popullsia banuese	18,227 banorë sipas Censit 2023; përqendrim më i lartë në njësinë Patos dhe shpërndarje rurale në Zharrëz e Ruzhdie.	Ndihmon në planifikimin e shërbimeve, paralajmërimit të hershëm, evakuimit dhe mbështetjes për grupet e cenueshme.
Sektorët kryesorë të të ardhurave	Bujqësi, blegtori, shërbime, tregti, biznes i vogël, aktivitete prodhuese dhe ndikim i sektorit hidrokarbur.	Sektorët janë të ekspozuar ndaj thatësirës, përmbytjeve, zjarreve, ndërprerjeve të energjisë dhe ndotjes mjedisore.
Bujqësia dhe toka	Ekonomi familjare e lidhur me tokën bujqësore, ullishtet, kulturat e arave, perimet, drufrutorët dhe blegtorinë.	Kërkon ujitje eficiente, kullim funksional, analiza toke, mbrojtje nga erozioni dhe kultura më rezistente ndaj thatësirës.

Biznesi i vogël dhe shërbimet	Përqendrohen në qendrën urbane dhe përgjatë akseve të lëvizjes, duke përfshirë tregti, transport, shërbime, ndërtim dhe aktivitete të vogla prodhuese.	Varet nga funksionimi i rrugëve, energjisë, ujit, menaxhimit të mbetjeve dhe siguria gjatë ngjarjeve ekstreme.
Sektori hidrokarbur dhe mjedisi	Trashëgimi dhe aktivitet ekonomik me ndikim në punësim, përdorim toke, cilësi mjedisi dhe risk teknologjik.	Kërkon monitorim të ajrit, ujit e tokës dhe protokolle reagimi kur përmbytjet, zjarret ose thatësirat shtojnë përhapjen e ndotësve.

Në planifikimin ekonomik të periudhës 2027-2036, Bashkia Patos duhet të përdorë këta tregues për të orientuar investimet në sektorët me përfitim të dyfishtë: ulje të riskut klimatik dhe rritje të qëndrueshmërisë ekonomike. Prioritet duhet t'i jepet rehabilitimit të ujitjes dhe kullimit, mbështetjes së fermerëve për praktika klimat-smart, përmirësimit të rrugëve vendore dhe pikave të tregtimit, rritjes së eficiencës energjetike në ndërtesa dhe biznese, si dhe krijimit të një sistemi vendor për mbledhjen periodike të të dhënave mbi dëmet ekonomike nga përmbytjet, thatësirat, zjarret dhe ndotja.

2.3 Kushtet socio-ekonomike dhe grupet e cenueshme

Grupet më të cenueshme ndaj ndikimeve klimatike përfshijnë të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, familjet me të ardhura të ulëta, fermerët e vegjël, banorët në zona të ekspozuara ndaj përmbytjeve ose rrëshqitjeve, si dhe komunitetet pranë zonave me ndotje teknologjike. Masat e planit duhet të garantojnë përfshirje gjinore, akses për të gjithë dhe mbrojtje të grupeve që kanë kapacitet më të kufizuar për t'u përshtatur.

2.3.1 Varfëria dhe përjashtimi social

Varfëria dhe përjashtimi social në Bashkinë Patos lidhen me disa faktorë të ndërthurur: uljen e popullsisë banuese, plakjen demografike, varësinë e familjeve rurale nga bujqësia dhe blegtoria, punësimin sezonal ose informal, si dhe praninë e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike ose shërbime të kujdesit shoqëror.

Nga pikëpamja klimatike, familjet me të ardhura të ulëta janë më të ekspozuara ndaj dëmeve nga përmbytjet, thatësirat, valët e të nxehtit dhe zjarret, sepse kanë më pak mundësi për riparim banese, sigurim të prodhimit bujqësor, blerje uji, energjie ose pajisjesh ftohjeje/ngrohjeje. Në zonat rurale, humbjet në prodhim bujqësor, dëmtimi i tokës, mungesa e ujit për ujitje dhe bllokimi i rrugëve ndikojnë drejtpërdrejt te të ardhurat familjare. Në zonën urbane, familjet me të ardhura të ulëta mund të preken më shumë nga stresi termik, banesat me izolim të dobët, kostot e energjisë dhe ndërprerjet e shërbimeve publike.

Plani Social 2025-2028 i Bashkisë Patos evidenton si grupe në nevojë familjet përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik përjashtimi, gratë në situatë kritike, të moshuarit në nevojë, minoritetet etnike dhe familjet që kanë nevojë për shërbime të

kujdesit shoqëror. Këto kategori përkojnë me grupet që kërkojnë vëmendje të veçantë edhe në planifikimin e përshtatjes klimatike, sepse kanë kapacitet më të kufizuar për t'u përgatitur, për t'u evakuuar, për të marrë informacion në kohë ose për t'u rikuperuar pas dëmeve.

Grupi i cenueshëm	Forma kryesore e cenueshmërisë	Ndikimi klimatik më i rëndësishëm
Familje me të ardhura të ulëta	Kapacitet i kufizuar financiar për riparime, sigurim, transport, energji dhe ujë.	Përmbytje, thatësira, valë të të nxehtit dhe ndërprerje shërbimesh.
Fermerë të vegjël dhe familje rurale	Varësi nga prodhimi bujqësor, blegtoria, toka dhe uji për ujitje.	Thatësira, dëmtime të tokës, erozion, përmbytje dhe zjarre.
Të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara	Nevojë për asistencë, shërbime shëndetësore, transport dhe komunikim të përshtatur.	Valë të të nxehtit, përmbytje, evakuim dhe ndërprerje të shërbimeve.
Fëmijë, gra në situatë kritike dhe komunitete të margjinalizuara	Varësi nga shërbimet sociale, arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja komunitare.	Ndërprerje e shkollimit, rritje e rrezikut shëndetësor dhe kufizim i aksesit në ndihmë.

	Përfitues NE	AK dhe invalidë pune	Fëmijë	Gra	Të moshuar	Të papunë	Romë Egjyptianë	Të pastrehë	Të rinj të papunë	Gjithsej
Patos	98	860	114	338	532	276	5	24	85	2.332
Zharrëz	126	292	68	97	127					710
Ruzhdic	50	121	110	35	20			4		340
Gjithsej	274	1.273	292	470	679	276	5	28	85	3.382
Në përqindje	8%	39%	9%	14%	21%	8%	0.1%	0.8%	2.5%	100%
Përfitojnë shërbime aktualisht		150[1]								150
Në % ndaj numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë		11.7%								4.4%
Individë në nevojë për shërbime	274	1.273	292	470	679	276	5	28	85	3.352
Në %	8	38	7.8	14	20	8	0.1	0.8	2.5	100

2.3.2 Treguesit shëndetësorë

Treguesit shëndetësorë për Bashkinë Patos duhet të vlerësohen në raport me strukturën demografike, shpërndarjen urbane-rurale, praninë e grupeve të cenueshme dhe ekspozimin ndaj ndotjes mjedisore e rreziqeve klimatike. Censi 2023 tregon se në Bashkinë Patos grupmosha 65 vjeç e lart përbën 4,236 banorë, ose rreth 23.2% të popullsisë banuese; kjo e bën shëndetin e të moshuarve një prioritet të veçantë për valët e të nxehtit, përmbytjet, evakuimin dhe vazhdimësinë e trajtimit mjekësor.

Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në shëndetin publik përmes rritjes së temperaturave, valëve të të nxehtit, përmbytjeve, ndotjes së ujit dhe ajrit, zjarreve dhe përhapjes së ndotësve nga zona të ndikuara nga aktiviteti hidrokarbur. Valët e të nxehtit rrisin riskun për dehidratim, lodhje termike, përkeqësim të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, veçanërisht te të moshuarit, fëmijët dhe personat me sëmundje kronike. Përmbytjet mund të dëmtojnë ujësjellësin, kanalizimet dhe pusetat, duke krijuar risk për ndotje të ujit, infeksione, dëmtime fizike dhe vështirësi në aksesin drejt qendrave shëndetësore.

Në nivel kombëtar, Censi 2023 raporton prevalencë të aftësisë së kufizuar prej 6.5% te popullsia 5 vjeç e lart, me përqendrim më të lartë te mosha 65 vjeç e lart. Edhe pse ky tregues nuk zëvendëson të dhënat vendore të regjistrave socialë, ai tregon rëndësinë e planifikimit të evakuimit, komunikimit të riskut, transportit dhe shërbimeve shëndetësore në mënyrë të aksesueshme. Për Bashkinë Patos, prioritet është krijimi i listave të përditësuara të personave që kanë nevojë për asistencë gjatë emergjencave, koordinimi me qendrat shëndetësore dhe shërbimet sociale, si dhe sigurimi i informacionit të thjeshtë e të përshtatur për valët e të nxehtit, përmbytjet, zjarret dhe ndotjen.

Treguesi shëndetësor	Rëndësia për Patosin	Përdorimi në planin klimatik
Popullsia 65+	4,236 banorë ose rreth 23.2% e popullsisë banuese.	Identifikim i personave që kanë nevojë për asistencë gjatë valëve të të nxehtit, përmbytjeve dhe evakuimit.
Persona me aftësi të kufizuara	Në nivel kombëtar prevalenca është 6.5% te popullsia 5 vjeç e lart; kërkohen të dhëna vendore nga shërbimet sociale.	Plan evakuimi, transport i aksesueshëm, komunikim i përshtatur dhe kontroll periodik gjatë emergjencave.
Sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare	Mund të përkeqësohen nga temperaturat e larta, ndotja e ajrit, pluhuri dhe tymi nga zjarret.	Monitorim i rasteve gjatë verës, këshillim publik dhe koordinim me qendrat shëndetësore.
Cilësia e ujit dhe higjiena	Përmbytjet dhe dëmtimi i kanalizimeve mund të krijojnë	Analiza pas ngjarjeve ekstreme, dezinfektim, komunikim publik dhe furnizim alternativ me ujë.

	risk për ndotje të ujit dhe sëmundje infektive.	

2.3.3 Treguesit arsimorë

Treguesit arsimorë janë të rëndësishëm për planin e përshtatjes klimatike sepse shkollat, kopshtet dhe institucionet arsimore janë njëkohësisht vende të përqendrimit të fëmijëve, qendra komunikimi me familjet dhe hapësira që mund të përdoren për edukim, ndërgjegjësim dhe, në raste emergjence, për mbështetje komunitare. Në nivel kombëtar, Censi 2023 raporton se shkalla e alfabetizmit për popullsinë 15 vjeç e lart është 97.7%, ndërsa 96.8% e popullsisë 15 vjeç e lart kanë përfunduar ose janë duke ndjekur shkollën. Këto të dhëna tregojnë një bazë të mirë për komunikim publik dhe edukim klimatik, por kërkojnë përshtatje për grupet me akses më të kufizuar në informacion.

Në Bashkinë Patos, sistemi arsimor duhet të konsiderohet sektor i ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike për shkak të ekspozimit të ndërtesave shkollore ndaj temperaturave të larta, reshjeve intensive, përmbytjeve lokale, ndërprerjeve të energjisë dhe vështirësive të transportit në rrugët rurale. Shkollat dhe kopshtet me izolim të dobët, mungesë hijezimi ose ventilim të pamjaftueshëm janë më të ekspozuara gjatë valëve të të nxehtit. Në njësitë rurale, reshjet intensive mund të vështirësojnë vajtjen e nxënësve në shkollë, sidomos kur rrugët dytësore, urat, tombinot ose kanalet kulluese janë të dëmtuara.

Përshtatja klimatike në sektorin e arsimit duhet të përfshijë vlerësimin teknik të ndërtesave arsimore, përmirësimin e termoizolimit, hijezimit, ventilimit dhe furnizimit me ujë, mirëmbajtjen e oborreve dhe pemëzimin, si dhe hartimin e planeve të emergjencës për çdo shkollë. Arsimi duhet të përdoret edhe si kanal ndërgjegjësimi për komunitetin, duke përfshirë tema mbi kursimin e ujit, parandalimin e zjarreve, sjelljen gjatë përmbytjeve, mbrojtjen nga temperaturat e larta dhe raportimin e ndotjes.

Treguesi arsimor	Kuptimi për planifikimin vendor	Masa e përshtatjes
Alfabetizmi dhe ndjekja e shkollës	Në nivel kombëtar, alfabetizmi 15+ është 97.7% dhe 96.8% kanë përfunduar ose ndjekin shkollën.	Përdorimi i shkollave si kanale edukimi dhe komunikimi për riskun klimatik.
Gjendja e ndërtesave arsimore	Ndërtesat mund të ekspozohen ndaj nxehtësisë, lagështisë, përmbytjeve lokale dhe ndërprerjeve të energjisë.	Termoizolim, hijezim, ventilim, gjelbërim oborresh dhe furnizim i sigurt me ujë.
Aksesi i nxënësve në shkollë	Rrugët rurale, urat dhe kanalet ndikojnë në vazhdimësinë e shkollimit gjatë reshjeve ekstreme.	Identifikim i rrugëve kritike, plane transporti dhe protokolle për mbyllje ose zhvendosje të përkohshme.

Edukimi klimatik	Nxënësit dhe mësuesit mund të jenë shumëfishues të informacionit në familje dhe komunitet.	Module praktike për ujë, zjarre, përmbytje, valë të të nxehtit, mbetje dhe ndotje.

Objektet arsimore përfshijnë 2 shkolla fillore, 6 shkolla 9-vjeçare dhe 3 shkolla të mesme. Të dhënat nga viti 2019 tregojnë se nivelet e regjistrimit në arsimin bazë kanë rënë në mënyrë drastike, me 31.4 % dhe në arsimin e mesëm të lartë kanë rënë me 34.7 % gjatë shtatë viteve të fundit, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Niveli arsimor	**Regjistruar 2018-2019**	**Regjistruar 2019-2020**	**Regjistruar 2020-2021**	**Regjistruar 2021-2022**	**Regjistruar 2022-2023**	**Regjistruar 2023-2024**	**Regjistruar 2024-2025**
Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët (arsimi 9-vjeçar) dhe Arsimi i mesëm i lartë (i përgjithshëm)	3099	2937	2759	2633	2468	2283	2099

2.4 Profilet e sektorëve prioritarë

Në përputhje me procesin e Planit Kombëtar të Përshtatjes dhe me dokumentet strategjike vendore të Bashkisë Patos, sektorët prioritarë në nivel vendor janë **bujqësia, zhvillimi urban, turizmi, energjia dhe transporti**. Këta sektorë janë të lidhur drejtpërdrejt me përdorimin e tokës, infrastrukturën publike, ekonominë vendore, shërbimet komunitare dhe ekspozimin ndaj përmbytjeve, thatësirave, valëve të të nxehtit, zjarreve, erozionit dhe ndotjes.

2.4.1 Bujqësia

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë dhe mirëqenien e familjeve në Bashkinë Patos, veçanërisht në njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdie, si dhe në zonat rurale përreth qytetit. Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027 e përcakton qëllimin kryesor si promovimin e një sektori bujqësor të qëndrueshëm, produktiv dhe konkurrues, me fokus në përmirësimin e jetesës së fermerëve, evidentimin e nevojave institucionale, teknike dhe financiare, si dhe orientimin e ndërhyrjeve për zhvillimin bujqësor. Dokumenti trajton ndarjen e tokës,

aktivitetet bujqësore në kultura arash, perime në serra, drufrutorë, blegtori, agropërpunim, subvencione, problematika dhe objektiva për zhvillimin e sektorit.

Në këndvështrimin e përshtatjes klimatike, bujqësia në Patos është e ekspozuar ndaj thatësirave verore, mungesës së ujit për ujitje, reshjeve intensive, përmbytjeve në tokat fushore, erozionit në zonat kodrinore dhe ndotjes së tokës ose ujit në zona me ndikim hidrokarbur. Plani vendor bujqësor dhe Raporti i Vlerësimit të Kapitalit Natyror theksojnë rëndësinë e burimeve ujore, rezervuarëve, sistemit të ujitjes e kullimit, tokës bujqësore, pyjeve, biodiversitetit dhe kapitalit natyror për zhvillimin lokal. Kjo do të thotë se masat për bujqësinë duhet të kombinojnë rritjen e prodhimit me mbrojtjen e burimeve natyrore dhe uljen e riskut klimatik.

Nënsektori	Çështja kryesore vendore	Orientimi i përshtatjes
Ujitja dhe kullimi	Nevojë për mirëmbajtje të kanaleve, rezervuarëve dhe pikave të shkarkimit.	Ujitje eficiente, pastrim kanalesh, menaxhim i ujit gjatë thatësirës dhe reshjeve ekstreme.
Kulturat bujqësore dhe drufrutorët	Prodhimi varet nga toka, uji, temperatura dhe aksesi në treg.	Kultura më rezistente ndaj thatësirës, analiza toke, mbrojtje nga erozioni dhe përdorim racional i inputeve.
Blegtoria dhe agropërpunimi	Të ardhurat familjare mbështeten nga blegtoria, produktet vendore dhe përpunimi në shkallë të vogël.	Siguri ushqimore, ujë për gjënë e gjallë, menaxhim i mbetjeve organike dhe zinxhirë të shkurtër tregtimi.

2.4.2 Zhvillimi urban

Zhvillimi urban i Bashkisë Patos orientohet nga Plani i Përgjithshëm Vendor dhe nga dokumentet e buxhetimit afatmesëm, të cilat e lidhin strukturimin e vendbanimeve, përmirësimin e infrastrukturës, hapësirat publike, shërbimet bazë dhe cilësinë e jetës me zhvillimin afatgjatë të territorit. Në dokumentet vendore, drejtimet kryesore të zhvillimit përfshijnë zhvillimin ekonomik, strukturimin dhe gjallërimin e vendbanimeve, si dhe aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe mjedisore. Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme për Patosin, sepse qyteti dhe zonat periurbane ndërthuren me fshatra, toka bujqësore, zona kodrinore, rrjet rrugor vendor dhe zona me ndikim industrial.

Nga pikëpamja klimatike, zhvillimi urban duhet të orientojë ndërtimet, rikualifikimet dhe investimet publike drejt uljes së ekspozimit ndaj përmbytjeve urbane, valëve të të nxehtit, erozionit, ndotjes dhe ndërprerjeve të shërbimeve. Rikualifikimi i blloqeve urbane, përmirësimi i rrugëve, trotuareve, ndriçimit publik, kanalizimeve, gjelbërimit dhe hapësirave rekreative duhet të

planifikohen si masa të integruara përshtatjeje. Për zonat urbane të Patosit, prioritet janë sistemimi i ujërave atmosferike, pastrimi i pusetave dhe kanaleve, shtimi i hijëzimit, përdorimi i materialeve që ulin nxehtësinë në hapësirat publike dhe përfshirja e rrezikut klimatik në lejet e zhvillimit dhe projektet e infrastrukturës.

Fusha urbane	Nevoja vendore	Masa e përshtatjes
Ujërat atmosferike	Pusetat, kanalet dhe rrjeti i kanalizimeve mbingarkohen gjatë reshjeve të dendura.	Sistemim drenazhi, mirëmbajtje periodike, sipërfaqe të përshkueshme dhe kontroll i mbetjeve në kanale.
Hapësirat publike	Sheshet, trotuaret dhe rrugët ndikojnë në komfortin termik dhe aksesin në shërbime.	Gjelbërim, hijezim, ndriçim LED, mobilim urban dhe korridore këmbësore më të sigurta.
Zhvillimi territorial	Ndërtimet dhe investimet duhet të shmangin zonat me risk përmbytjeje, erozioni ose ndotjeje.	Integrim i hartave të riskut në planifikim, kontroll ndërtimi dhe kushtëzim i lejeve me masa mbrojtëse.

2.4.3 Turizmi

Turizmi në Bashkinë Patos trajtohet si sektor plotësues i zhvillimit vendor, i lidhur me diversifikimin ekonomik, promovimin e kapitalit natyror dhe kulturor, agroturizmin, edukimin mjedisor dhe përmirësimin e imazhit territorial. Plani Lokal për Zhvillimin e Turizmit 2026-2031 synon ta pozicionojë turizmin si instrument që promovon asetet natyrore, kulturore dhe historike, duke forcuar identitetin lokal dhe duke krijuar përfitime për komunitetin. Dokumenti mbështetet në qasjen e kapitalit natyror dhe lidhet me burimet minerare, ujore, pyjore, bujqësore, biodiversitetin, peizazhin dhe trashëgiminë kulturore.

Asetet me potencial turistik përfshijnë elemente të peizazhit kodrinor, burimet ujore, rezervuarët e Zharrëzës dhe Ruzhdies, Ujëvarat në kanionin e Siqecës, Rrapin e Zhugrit, Kalanë e Margëlliçit, objektet e kultit dhe trashëgimisë shpirtërore, si dhe identitetin e zonës së Patosit si territor me histori bujqësore, industriale dhe kulturore. Megjithatë, turizmi është i ndjeshëm ndaj zjarreve, thatësirave, degradimit të pyjeve, ndotjes, mungesës së mirëmbajtjes së shtigjeve dhe dëmtimit të aksesit rrugor gjatë reshjeve intensive. Për këtë arsye, zhvillimi i turizmit duhet të bazohet në mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve, sigurinë e vizitorëve dhe përfshirjen e komuniteteve rurale.

Produkti/potenciali	Rreziku klimatik/mjedisor	Ndërhyrja e rekomanduar
Turizmi natyror dhe peizazhor	Zjarre, erozion, thatësirë, dëmtim i shtigjeve dhe humbje e biodiversitetit.	Shtigje të mirëmbajtura, sinjalistikë, pika informimi, pastrim periodik dhe masa kundër zjarreve.

Trashëgimia kulturore	Dëmtime nga reshje intensive, mungesë mirëmbajtjeje dhe akses i kufizuar.	Inventarizim, sinjalistikë kulturore, mirëmbajtje, rrugë aksesi dhe paketim i itinerareve lokale.
Agroturizmi dhe produktet vendore	Thatësira, humbje prodhimi, mungesë uji dhe ndotje e mjedisit.	Lidhje me fermerët, panaire lokale, edukim mjedisor, menaxhim mbetjesh dhe standarde higjieno-sanitare.

2.4.4 Energjia

Sektori i energjisë në Bashkinë Patos lidhet kryesisht me konsumin e energjisë në ndërtesat publike, ndriçimin publik, shërbimet bashkiake, furnizimin me ujë, objektet arsimore e sociale dhe aktivitetet ekonomike vendore. Dokumentet buxhetore dhe projektet vendore e trajtojnë energjinë si fushë ku kërkohet rritje e eficiencës, ulje e kostove operative dhe përmirësim i cilësisë së shërbimeve.

Ndryshimet klimatike ndikojnë te energjia përmes rritjes së kërkesës për ftohje gjatë valëve të të nxehtit, rritjes së kostove për institucionet publike, ndërprerjeve të mundshme të furnizimit gjatë ngjarjeve ekstreme dhe nevojës për vazhdimësi shërbimi në shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, administratë dhe emergjenca civile. Raporti i Vlerësimit të Kapitalit Natyror për Bashkinë Patos përfshin edhe vlerësimin e burimeve natyrore dhe potencialit energjetik, duke evidentuar rëndësinë e rrezatimit diellor, burimeve ujore dhe kapitalit natyror në planifikimin vendor. Për këtë arsye, përshtatja klimatike në sektorin e energjisë duhet të përfshijë auditime energjetike, ndriçim LED, termoizolim, panele fotovoltaike në objekte publike, pajisje eficiente dhe plane për furnizim rezervë në objektet kritike.

Fusha energjetike	Problemi/ndikimi	Masa prioritare
Ndërtesat publike	Konsum i lartë energjie për ngrohje/ftohje dhe komfort i ulët gjatë temperaturave ekstreme.	Auditim energjetik, termoizolim, ventilim, hijezim dhe pajisje eficiente.
Ndriçimi publik	Kosto operative dhe nevojë për siguri gjatë emergjencave dhe lëvizjes në mbrëmje.	Zëvendësim gradual me LED, mirëmbajtje dhe prioritizim në akset kryesore e zonat e cenueshme.
Energjia diellore	Rritje e kërkesës për energji gjatë verës dhe nevojë për ulje të varësisë nga rrjeti.	Panele fotovoltaike në ndërtesa publike, veçanërisht shkolla, administratë dhe objekte sociale.

2.4.5 Transporti

Transporti është sektor kritik për Bashkinë Patos, sepse siguron lidhjen e qytetit me njësitë administrative, fshatrat, tokat bujqësore, shkollat, qendrat shëndetësore, tregjet dhe akset rajonale drejt Fierit, Ballshit dhe zonave përreth. Dokumentet vendore e lidhin transportin me zhvillimin ekonomik, aksesin në shërbime, investimet publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Nga pikëpamja klimatike, rrjeti rrugor vendor është i ekspozuar ndaj përmbytjeve, rrëshqitjeve, erozionit, dëmtimit të tombinove, bllokimit të kanaleve anësore, zjarreve dhe temperaturave të larta që përkeqësojnë gjendjen e shtresave rrugore. Rrugët rurale janë veçanërisht të rëndësishme për fermerët, nxënësit, qendrat shëndetësore, shërbimet emergjente dhe transportin e produkteve bujqësore. Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030 dhe Plani Vendor i Emergjencave Civile 2024-2030 kërkojnë që infrastruktura kritike të vlerësohet për risk, të ketë procedura mirëmbajtjeje, akses të garantuar për emergjencat dhe koordinim të qartë ndërmjet shërbimeve bashkiake, MZSH-së, administratorëve të njësive dhe komunitetit.

Elementi i transportit	Cenueshmëria	Masa e përshtatjes
Rrugët rurale	Dëmtime nga reshjet, baltë, bllokim drenazhi dhe akses i kufizuar në fshatra.	Drenazh anësor, tombino funksionale, mirëmbajtje para sezonit të reshjeve dhe hartëzim i pikave kritike.
Aksesi në shërbime	Shkollat, qendrat shëndetësore dhe shërbimet emergjente mund të ndërpriten gjatë ngjarjeve ekstreme.	Itinerare alternative, protokolle evakuimi, prioritet për rrugët drejt objekteve kritike.
Transporti publik dhe lëvizshmëria	Banorët pa automjet privat janë më të varur nga linjat dhe infrastruktura e përditshme.	Pika ndalimi të sigurta, informacion publik, sinjalistikë, ndriçim dhe lidhje me planet e emergjencës.

3. Qeverisja dhe kuadri rregullator

Bashkia Patos ka përgjegjësi të drejtpërdrejta për mbrojtjen civile, planifikimin e territorit, shërbimet publike, menaxhimin e mbetjeve, pyjet, bujqësinë vendore, edukimin komunitar dhe koordinimin me institucionet qendrore. Këto funksione duhet të integrojnë në mënyrë të qartë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

- Ligji për mbrojtjen civile përcakton detyrimet vendore për parandalim, gatishmëri, përgjigje dhe rimëkëmbje.

- Ligji për ndryshimet klimatike kërkon integrimin e masave klimatike në politikat dhe planet vendore.
- Ligji për vetëqeverisjen vendore përcakton funksionet e bashkisë në shërbime publike, planifikim dhe zhvillim vendor.
- Kuadri për planifikimin e territorit kërkon shmangien e zhvillimeve në zona me risk dhe orientimin e investimeve drejt qëndrueshmërisë.
- Kuadri për ujitjen, kullimin, pyjet dhe mjedisin mbështet masat për përmbytjet, thatësirat, zjarret, erozionin dhe ndotjen.

3.1 Profili i qeverisjes në Patos

Qeverisja vendore në Bashkinë Patos mbështetet në funksionet e përcaktuara nga ligji për vetëqeverisjen vendore, ku bashkia është përgjegjëse për shërbimet publike vendore, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, mirëmbajtjen e infrastrukturës, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e mjedisit, pyjet dhe kullotat, mbrojtjen civile, arsimin parashkollor dhe mbështetjen sociale. Në kontekstin e përshtatjes klimatike, këto funksione duhet të trajtohen në mënyrë të integruar, sepse përmbytjet, thatësirat, zjarret, valët e të nxehtit, rrëshqitjet dhe ndotja prekin njëkohësisht infrastrukturën, shëndetin, bujqësinë, mjedisin, ekonominë vendore dhe sigurinë e komunitetit.

Dokumentet vendore për zvogëlimin e riskut dhe emergjencat civile tregojnë se Bashkia Patos ka ngritur një qasje ndërsektoriale, ku përfshihen drejtoria/struktura e emergjencave civile, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, financa, të ardhurat vendore, projektet, shërbimet publike, zhvillimi bujqësor, pyjet dhe mjedisi, bordi i kullimit, arsimi, kultura dhe sportet, shëndetësia, MZSH-ja, policia bashkiake, burimet njerëzore, IVMT-ja, Ndërmarrjet e Shërbimeve Publike dhe administratorët e njësive administrative Zharrëz dhe Ruzhdie. Kjo përbërje është e rëndësishme për Planin Vendor të Përshtatjes, sepse masat klimatike kërkojnë koordinim të përditshëm ndërmjet sektorëve teknikë, njësive administrative, institucioneve qendrore dhe komunitetit.

Struktura/aktori	Roli në përshtatjen klimatike
Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak	Miratojnë prioritetet, buxhetet, planet vendore dhe raportet e monitorimit.
Emergjencat civile, MZSH dhe policia bashkiake	Koordinojnë parandalimin, gatishmërinë, reagimin, evakuimin dhe komunikimin gjatë ngjarjeve ekstreme.
Planifikimi territorial, IVMT dhe shërbimet publike	Integrojnë riskun klimatik në lejet, investimet, mirëmbajtjen urbane, rrugët, kanalizimet dhe hapësirat publike.
Bujqësia, pyjet, mjedisi dhe bordi i kullimit	Menaxhojnë ujitjen, kullimin, tokën, pyjet, zjarret, ndotjen dhe masat e mbrojtjes së ekosistemeve.

Arsimi, shëndetësia dhe shërbimet sociale	Mbrojnë grupet e cenueshme, organizojnë edukimin klimatik dhe sigurojnë vijimësinë e shërbimeve gjatë emergjencave.

3.2 Objekti i Planit Vendor të Përshtatjes

Objekti i Planit Vendor të Përshtatjes për Bashkinë Patos është të përcaktojë drejtimet, masat, përgjegjësitë dhe mekanizmat e monitorimit për uljen e cenueshmërisë së territorit dhe komunitetit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike gjatë periudhës 2027-2036. Plani nuk zëvendëson dokumentet ekzistuese të zhvillimit, emergjencave civile, buxhetimit apo planifikimit territorial, por i lidh ato me objektivat klimatike dhe krijon një kornizë të përbashkët për investime, shërbime publike dhe veprime parandaluese.

Objekti i planit përfshin:

- identifikimin e rreziqeve klimatike kryesore për Patosin;
- vlerësimin e ekspozimit dhe cenueshmërisë së popullsisë, infrastrukturës, bujqësisë, mjedisit, pyjeve, energjisë, transportit dhe shërbimeve publike;
- përcaktimin e masave prioritare për përshtatje;
- integrimin e këtyre masave në PBA, planet sektoriale dhe projektet e investimeve;
- vendosjen e treguesve të monitorimit.

Për bashkinë Patos, vëmendje e veçantë i kushtohet përmbytjeve dhe reshjeve intensive, thatësirave, mungesës së ujit për bujqësi, zjarreve në pyje e territore bujqësore, rrëshqitjeve, erozionit, valëve të të nxehtit dhe riskut teknologjik/mjedisor të lidhur me aktivitetin hidrokarbur.

Në aspektin territorial, plani mbulon qytetin Patos, njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdie, fshatrat përkatëse, zonat bujqësore, rrjetin e kanaleve ujitëse e kulluese, zonat kodrinore, pyjet, rezervuarët, rrugët vendore, objektet publike dhe zonat e ndikuara nga aktiviteti industrial. Në aspektin institucional, plani kërkon bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Patos, Këshillit Bashkiak, Prefekturës së Qarkut Fier, AKMC-së, AKM-së, ASIG-ut, institucioneve të bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, operatorëve të ujitjes/kullimit, strukturave të MZSH-së, policisë bashkiake, bizneseve, fermerëve, shkollave, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore.

Elementi i objektit	Përmbajtja për Bashkinë Patos
Qëllimi	Ulja e riskut klimatik dhe forcimi i aftësisë ripërtëritëse të komunitetit, ekonomisë, mjedisit dhe shërbimeve publike.
Sektorët	Bujqësia, uji, infrastruktura, zhvillimi urban, mjedisi, pyjet, shëndeti, arsimi, energjia, transporti dhe mbrojtja civile.
Rezultatet e pritshme	Masa të financueshme, projekte të prioritizuara, indikatorë monitorimi, koordinim institucional dhe përfshirje komunitare.

Integrimi	Përfshirje në PBA, planet e emergjencave, PPV, planet sektoriale, projektet kapitale dhe raportimin vjetor.

3.3 Lidhjet me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe kuadrin e planifikimit

Plani Vendor i Përshtatjes për Bashkinë Patos lidhet me kuadrin kombëtar të zhvillimit, klimës, mbrojtjes civile, planifikimit territorial dhe menaxhimit financiar vendor. Në nivel kombëtar, referenca kryesore është Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036, i miratuar me VKM nr. 432, datë 10.06.2026, i cili kërkon që masat e përshtatjes të integrohen në politikat sektoriale, planifikimin vendor, investimet publike, menaxhimin e riskut dhe monitorimin e rezultateve.

Në fushën e mbrojtjes civile, plani lidhet me ligjin për mbrojtjen civile dhe me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, si dhe me dokumentet vendore të Bashkisë Patos për ZRF dhe emergjencat civile. Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030 dhe Plani Vendor për Emergjencat Civile 2024-2030 krijojnë bazën për identifikimin e rreziqeve, hartëzimin e ekspozimit, koordinimin e strukturave, planifikimin e reagimit dhe forcimin e kapaciteteve. Plani i përshtatjes duhet t'i përdorë këto dokumente si bazë për të kaluar nga reagimi pas fatkeqësisë drejt parandalimit, investimeve reziliente dhe uljes së riskut përpara se të ndodhin dëmet.

Në nivel vendor, lidhja më e rëndësishme është me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Patos, Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe planet sektoriale për bujqësinë, turizmin, mbetjet, emergjencat civile, arsimin, shërbimet sociale dhe kapitalin natyror. PPV përcakton kuadrin e përdorimit të territorit, orientimin e zhvillimeve dhe mbrojtjen e hapësirave, ndërsa PBA përcakton burimet financiare dhe prioritetet e investimeve. Për këtë arsye, masat e përshtatjes duhet të pasqyrohen në projektet kapitale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe kanaleve, shërbimet publike, gjelbërimin, rehabilitimin e zonave të degraduara, menaxhimin e mbetjeve, energjinë në ndërtesa publike dhe mbështetjen e bujqësisë.

Dokumenti/kuadri	Lidhja me Planin Vendor të Përshtatjes
Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036	Vendos prioritetet kombëtare të përshtatjes dhe kërkon integrim në nivel vendor e sektorial.
Ligji për ndryshimet klimatike dhe ligji për mbrojtjen civile	Krijojnë bazën ligjore për planifikim, parandalim, gatishmëri, raportim dhe koordinim institucional.
Strategjia Vendore për ZRF 2024-2030 dhe Plani Vendor i Emergjencave Civile 2024-2030	Sigurojnë hartëzimin e rreziqeve, strukturat përgjegjëse, protokollet e reagimit dhe listën e masave parandaluese.
Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Patos	Orienton përdorimin e territorit, shmangien e zhvillimeve në zona me risk dhe mbrojtjen e hapësirave natyrore.

Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028	Mundëson financimin e masave për ujë, kullim, gjelbërim, mbetje, rrugë, energji, shërbime publike dhe mbrojtje civile.
Planet sektoriale vendore	Përkthejnë masat klimatike në ndërhyrje konkrete për bujqësinë, mbetjet, turizmin, arsimin, shërbimet sociale, mjedisin dhe kapitalin natyror.

4. Procesi i hartimit dhe angazhimi i palëve të interesit

Hartimi i planit kërkon një proces gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e strukturave të Bashkisë Patos, njësive administrative, Prefekturës së Qarkut Fier, AKMC-së, institucioneve mjedisore, operatorëve të ujitjes dhe kullimit, strukturave shëndetësore e arsimore, sektorit privat, fermerëve, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore.

Procesi duhet të mbështetet në konsultime publike, ëorkshop-e teknike, mbledhje të të dhënave, hartëzim të risqeve, verifikim në terren dhe rishikim periodik.

Me urdhër të Kryetarit te Bashkisë është ngritur grupi i punës, i cili do të mbledhë të dhënat e nevojshme për hartimin e Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. Ky grup pune do të sigurojë mbarëvajtjen e punës për konsultimin publik me aktorë të ndryshëm deri në miratimin e planit në Këshillin Bashkiak.

4.1 Organizimi i nevojshëm institucional për procesin e PVP-së

Organizimi institucional për procesin e Planit Vendor të Përshtatjes duhet të ndërtohet mbi strukturat ekzistuese të Bashkisë Patos dhe përvojën e krijuar nga dokumentet vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, emergjencat civile, buxhetimin afatmesëm, planin social dhe menaxhimin e mbetjeve. Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030 për Patosin evidenton një grup pune të gjerë me përfaqësues nga drejtimi politik i bashkisë, emergjencat civile, planifikimi territorial, financa, të ardhurat vendore, projektet, shërbimet publike, zhvillimi bujqësor, pyjet dhe mjedisi, bordi i kullimit, arsimi, shëndetësia, MZSH-ja, policia bashkiake, burimet njerëzore, IVMT-ja, Agjencia e Shërbimeve Publike dhe administratorët e njësive administrative Zharrëz dhe Ruzhdie. Kjo strukturë është bazë e përshtatshme për ngritjen e grupit drejtues dhe teknik të PVP-së.

DRAFT

Sektori prioritar i PVP- së	Drejtoria/sektori përgjegjës	Pozicionet që mbulojnë detyrat	si % e të gjithë stafit	Komente
Planifikimi Urban dhe Pyjet	Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	6	5%	Numri i stafit që mbulon planifikimin urban është 5
	Sektori i Mjedisit dhe Pyjeve	4	3.3%	Numri i stafit që mbulon mjedisin dhe pyjet është 4
Turizmi	Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve	1	0.8%	Numri i stafit që mbulon turizmin është 1
Bujqësia	Sektori i Zhvillimit Bujqësor dhe Bordit të Kullimit	7	5.8%	Numri i stafit që mbulon zhvillimin bujqësor dhe bordin e kullimit është 7
Transporti	Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	5	4.2%	Numri i stafit që mbulon planifikimin urban dhe transportin është 5
Energjia	Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile	3	2.5%	Numri i stafit që mbulon energjinë është 3

4.2 Proceset e angazhimit të palëve të interesit

Procesi i angazhimit të palëve të interesit për PVP-në duhet të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe i dokumentuar. Bashkia Patos ka përvojë të mëparshme në organizimin e konsultimeve publike për dokumente vendore. Njoftimet publike të bashkisë parashikojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, kryetarëve të fshatrave, banorëve të Patosit dhe njësive Zharrëz e Ruzhdie, shoqërisë civile, institucioneve publike, grupeve të interesit dhe organizatave që zbatojnë politika sociale ose shërbime publike. Kjo praktikë duhet të përdoret edhe për PVP-në, me fokus të veçantë te grupet e cenueshme dhe sektorët më të prekur nga klima.

Angazhimi duhet të zhvillohet në disa faza:

(i) identifikimi i palëve të interesit dhe krijimi i listës së kontaktit;
(ii) mbledhja e të dhënave nga drejtoritë bashkiake dhe njësitë administrative;
(iii) takime teknike me sektorët e bujqësisë, ujitjes/kullimit, mjedisit, shëndetësisë, arsimit, shërbimeve publike dhe emergjencave civile;
(iv) konsultime territoriale në Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie për verifikimin e pikave të riskut;
(v) konsultim publik për draft-planin;
(vi) reflektimi i komenteve;
(vii) paraqitja e planit për miratim në Këshillin Bashkiak.

DRAFT

Pala e interesit	Çështjet ku duhet të angazhohet	Forma e angazhimit
Banorët, kryetarët e fshatrave dhe njësitë administrative	Përmbytje, rrugë të dëmtuara, mungesë uji, zjarre, rrëshqitje, shërbime publike dhe problematika lokale.	Takime në Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie, pyetësorë, verifikime në terren dhe procesverbale.
Fermerët, blegtorët dhe bizneset lokale	Thatësira, ujitja, kullimi, dëmtimi i prodhimit, tregjet, energjia, mbetjet bujqësore dhe ndotja.	Fokus-grupe sektoriale, takime me shoqatat/fermerët dhe konsultime për masat bujqësore.
Shkollat, qendrat shëndetësore dhe shërbimet sociale	Valët e të nxehtit, evakuimi, grupet e cenueshme, edukimi klimatik dhe vazhdimësia e shërbimeve.	Takime tematike, lista të grupeve në nevojë, ushtrime praktike dhe fushata informimi.
Institucionet qendrore dhe rajonale	Të dhëna për riskun, hartat, mbrojtjen civile, mjedisin, bujqësinë, ujin, shëndetin dhe planifikimin territorial.	Shkëmbim të dhënash, takime teknike, opinione zyrtare dhe koordinim për financime.
Shoqëria civile, grupet e grave, të rinjtë dhe komunitetet e cenueshme	Përfshirja sociale, barazia gjinore, aksesueshmëria, informimi publik dhe ndikimet mbi familjet në nevojë.	Konsultime të dedikuara, pyetësorë, kanale online dhe përfshirje në monitorim.

4.3 Informacione/organizime institucionale shtesë të nevojshme për procesin e PVP-së

Për hartimin dhe zbatimin efektiv të PVP-së, Bashkia Patos ka nevojë për disa organizime dhe informacione shtesë që plotësojnë të dhënat ekzistuese të dokumenteve vendore. Këto lidhen me përditësimin e të dhënave klimatike dhe territoriale, inventarizimin e aseteve publike, vlerësimin e cenueshmërisë së infrastrukturës, sistemin e raportimit të dëmeve, bazën e të dhënave për grupet e cenueshme dhe mekanizmat për integrimin e masave në PBA. Raporti i Vlerësimit të Riskut në Shkallë Vendore për Patosin përfshin harta të ekspozimit, infrastrukturës kritike, popullsisë, rrezikut nga zjarret në pyje, rrezikut teknologjik, përmbytjet, rrëshqitjet dhe rrezikun biologjik, të cilat duhet të përdoren si bazë fillestare për hartëzimin klimatik të PVP-së.

Një nevojë kryesore është krijimi i një **regjistri vendor të ngjarjeve klimatike dhe dëmeve**, ku të regjistrohen përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet, thatësirat, ndërprerjet e shërbimeve, dëmet në rrugë, kanale, shkolla, banesa, toka bujqësore dhe asete publike. Regjistri duhet të përditësohet pas çdo ngjarjeje, të lidhet me fotografi dhe koordinata, dhe të përdoret për prioritizimin e investimeve. Gjithashtu, duhet të krijohet një bazë e të dhënave për objektet kritike, përfshirë shkollat, kopshtet, qendrat shëndetësore, objektet administrative, rrugët kryesore, urat, tombinot, rezervuarët, kanalet kulluese, pikat e depozitimit të mbetjeve dhe zonat me risk teknologjik.

Nevoja shtesë	Përshkrimi	Struktura përgjegjëse
Regjistër i ngjarjeve klimatike dhe dëmeve	Datë, vendndodhje, lloj ngjarjeje, dëme, kosto, fotografi, koordinata dhe masa e marrë.	Emergjencat civile, shërbimet publike, njësitë administrative.
Inventar i aseteve publike dhe infrastrukturës kritike	Shkolla, qendra shëndetësore, rrugë, ura, tombino, kanale, rezervuarë, ndriçim, objekte administrative dhe pika shërbimi.	Planifikimi territorial, shërbimet publike, projektet, financa.
Hartëzim i cenueshmërisë klimatike	Shtresat për përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet, ndotjen, zonat urbane të nxehta, grupet e cenueshme dhe asetet kritike.	Bashkia Patos, ASIG, AKMC, AKM dhe partnerë teknikë.
Listë e përditësuar e grupeve të cenueshme	Të moshuar në nevojë, persona me aftësi të kufizuara, familje me ndihmë ekonomike, fëmijë në risk dhe familje pranë zonave të ekspozuara.	Shërbimet sociale, shëndetësia, njësitë administrative.
Mekanizëm buxhetimi dhe monitorimi	Kodifikim i masave në PBA, kosto, burime financimi, indikatorë dhe raport vjetor progresi.	Financa, projektet, Këshilli Bashkiak dhe Grupi Drejtues i PVP-së.

Organizimet shtesë duhet të lidhen drejtpërdrejt me dokumentet ekzistuese vendore. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2026-2030 për Patosin përfshin indikatorë performance, objektiva, skema grumbullimi, minimizim mbetjesh, ndarje në burim, riciklim, kompostim, fushata ndërgjegjësimi dhe plan veprimi/monitorimi; këto elemente duhet të përdoren për masat klimatike që lidhen me përmbytjet urbane, bllokimin e kanaleve dhe ndotjen. PBA 2026-2028 duhet të përdoret për financimin e masave, ndërsa Plani Social 2025-2028 duhet të përdoret për identifikimin e grupeve të cenueshme dhe komunikimin e riskut.

Në fund të procesit të hartimit, Bashkia Patos duhet të ketë një paketë minimale institucionale për zbatimin e PVP-së: vendim për grupin drejtues, pikë kontakti për klimën, kalendar konsultimesh, bazë të dhënash për riskun dhe dëmet, listë masash me kosto paraprake, mekanizëm të integrimit në PBA dhe format raportimi vjetor. Raporti vjetor duhet t'i paraqitet Këshillit Bashkiak dhe të publikohet për komunitetin, duke përfshirë progresin e masave, fondet e përdorura, ngjarjet klimatike të ndodhura, dëmet e raportuara, vështirësitë dhe rekomandimet për vitin pasardhës.

5. Informacioni klimatik dhe rreziqet kryesore

Ky kapitull paraqet informacionin bazë klimatik dhe rreziqet kryesore që prekin Bashkinë Patos. Vëmendja përqendrohet te reshjet intensive dhe përmbytjet, thatësirat, valët e të nxehtit, zjarret në pyje e territore bujqësore, rrëshqitjet dhe erozioni, si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi

cilësinë e ujit, tokës dhe ajrit. Për Patosin, këto rreziqe ndërthuren edhe me riskun teknologjik dhe mjedisor të lidhur me aktivitetin hidrokarbur, çka kërkon një qasje më të integruar të përshtatjes.

Rreziku klimatik	Ndikimi i pritshëm	Sektorët e prekur
Përmbytje dhe reshje intensive	Dëmtime të rrugëve, kanaleve, tokave bujqësore, banesave dhe infrastrukturës publike në zona të ulëta dhe pranë rrjetit kullues.	Infrastrukturë, bujqësi, shëndet publik, shërbime publike.
Thatësira dhe mungesë uji	Presion mbi ujitjen, bujqësinë, rezervuarët, furnizimin me ujë dhe produktivitetin ekonomik gjatë verës.	Bujqësi, ujë, energji, mjedis.
Valë të të nxehtit	Rritje e kërkesës për ftohje, ndikime në shëndet, ulje e produktivitetit dhe stres termik në zonat urbane.	Shëndet, ndërtesa, energji, ekonomi.
Zjarre në territor	Dëmtime të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe cilësisë së ajrit, si dhe risk për banorët dhe asetet.	Pyje, bujqësi, shëndet, mbrojtje civile.
Rrëshqitje dhe erozion	Dëmtime në rrugë, toka bujqësore, shpate dhe vendbanime në zona kodrinore.	Transport, bujqësi, planifikim territorial, mjedis.
Risk teknologjik dhe ndotje	Rrezik për cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe shëndetin e komunitetit, veçanërisht në zona të ndikuara nga aktiviteti hidrokarbur.	Mjedis, shëndet, ekonomi, mbrojtje civile.

5.1 Përshkrim i detajuar i rreziqeve klimatike për Bashkinë Patos

Rreziqet klimatike në Bashkinë Patos duhet të kuptohen si procese të ndërlidhura, ku një ngjarje atmosferike mund të shkaktojë pasoja të njëpasnjëshme në infrastrukturë, shëndet, bujqësi, ekonomi, mjedis dhe shërbime publike. Për shembull, reshjet intensive mund të sjellin përmbytje, bllokim të kanaleve kulluese, ndotje të ujërave, dëmtim të rrugëve rurale, humbje të prodhimit bujqësor dhe rritje të riskut shëndetësor për komunitetin. Po kështu, thatësira dhe temperaturat e larta mund të rrisin kërkesën për ujë e energji, të ulin prodhimtarinë bujqësore, të shtojnë riskun e zjarreve dhe të përkeqësojnë cilësinë e ajrit.

5.1.1 Përmbytjet dhe reshjet intensive

Përmbytjet përbëjnë një nga rreziqet më të rëndësishme klimatike për Bashkinë Patos, veçanërisht në zonat fushore dhe në territorin ku rrjeti kullues është i mbingarkuar, i dëmtuar ose i pamirëmbajtur. Reshjet intensive në periudha të shkurtra mund të tejkalojnë kapacitetin e kanaleve kulluese, të shkaktojnë dalje të ujit në sipërfaqe, dëmtime në rrugë, bllokim të qarkullimit dhe përmbytje të tokave bujqësore.

Zonat që kërkojnë vëmendje të veçantë janë vendbanimet dhe tokat pranë lumit Seman, kanalet kulluese në Belinë, Zharëz, Sheqishte dhe zonat e ulëta bujqësore. Rreziku rritet kur reshjet intensive ndodhin pas periudhave të thata, sepse toka e ngjeshur dhe e thatë ka kapacitet më të ulët thithjeje. Përmbytjet mund të sjellin edhe ndotje sekondare, pasi ujërat sipërfaqësore mund të përzihen me mbetje urbane, mbetje bujqësore, ujëra të ndotura ose ndotje të lidhur me aktivitetin hidrokarbur.

5.1.2 Thatësirat dhe mungesa e ujit

Thatësirat pritet të jenë më të shpeshta dhe më të gjata gjatë periudhave të verës, duke ndikuar drejtpërdrejt në bujqësi, blegtori, furnizimin me ujë, rezervuarët dhe shërbimet publike. Në Patos, ku bujqësia dhe përdorimi i tokës kanë rëndësi ekonomike dhe sociale, mungesa e ujit për ujitje mund të ulë rendimentin, të rrisë koston e prodhimit dhe të shtojë presionin mbi fermerët e vegjël.

Thatësira ndikon edhe në cilësinë e ujit, pasi ulja e prurjeve dhe rritja e temperaturës mund të rrisin përqendrimin e ndotësve. Në zonat ku ka aktivitet hidrokarbur ose histori ndotjeje, kjo mund të përkeqësojë riskun mjedisor dhe shëndetësor. Për këtë arsye, menaxhimi i qëndrueshëm i ujit duhet të përfshijë rehabilitimin e rrjetit ujitës dhe kullues, përdorimin e teknologjive eficiente, monitorimin e rezervuarëve, ripërdorimin e ujit aty ku është e mundur dhe mbështetjen e fermerëve për kultura më rezistente ndaj thatësirës.

5.1.3 Valët e të nxehtit dhe temperaturat ekstreme

Valët e të nxehtit ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin publik, veçanërisht tek të moshuarit, fëmijët, personat me sëmundje kronike, punonjësit në terren dhe familjet me kushte të dobëta banimi. Në zonat urbane të Patosit, temperaturat e larta mund të përforcohen nga sipërfaqet e asfaltuara, mungesa e hijezimit, dendësia e ndërtimeve dhe hapësirat e kufizuara të gjelbra.

Pasojat përfshijnë stres termik, rritje të kërkesës për shërbime shëndetësore, ulje të produktivitetit të punës, rritje të konsumit të energjisë për ftohje dhe rritje të rrezikut për ndërprerje të energjisë në periudha piku. Masat për përshtatje duhet të përfshijnë shtimin e gjelbërimit urban, hijezimin e hapësirave publike, termoizolimin e ndërtesave publike, krijimin e hapësirave të freskëta për komunitetin dhe protokollet e paralajmërimit për valët e të nxehtit.

5.1.4 Zjarret në pyje, kullota dhe territore bujqësore

Rritja e temperaturave, thatësirat dhe periudhat me erë shtojnë riskun e zjarreve në pyje, kullota dhe sipërfaqe bujqësore. Në Bashkinë Patos, zonat pyjore dhe kodrinore, veçanërisht në Njësinë Administrative Ruzhdie dhe në territoret pranë pyllit Drenie, kërkojnë vëmendje të shtuar për parandalim, vrojtim dhe ndërhyrje të shpejtë.

Zjarret ndikojnë në biodiversitet, cilësinë e ajrit, tokën, prodhimin bujqësor dhe sigurinë e banorëve. Nëse zjarri ndodh pranë zonave me ndotje, depozitime të mbetjeve ose instalime teknologjike, pasojat mund të jenë më të rënda. Masat prioritare përfshijnë mirëmbajtjen e rrugëve

pyjore, brezat kundër zjarrit, pikat e furnizimit me ujë, pajisjen e MZSH-së, fushatat kundër djegies së pakontrolluar të mbetjeve bujqësore dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me bashkitë fqinje.

5.1.5 Rrëshqitjet e tokës dhe erozioni

Rrëshqitjet e tokës dhe erozioni lidhen me pjerrësinë e terrenit, ndërhyrjet në shpat, mungesën e mbulesës bimore, reshjet intensive dhe praktikat e papërshtatshme të përdorimit të tokës. Zonat kodrinore të Zharëzës, Dukasit, Ruzhdies dhe Gjinoqarës duhet të trajtohen si zona ku kërkohet monitorim i vazhdueshëm, studim gjeologjik dhe masa parandaluese.

Rrëshqitjet mund të dëmtojnë rrugët vendore, banesat, tokat bujqësore, kanalet dhe rrjetet e shërbimeve. Erozioni ul pjellorinë e tokës, rrit sedimentimin e kanaleve dhe rezervuarëve dhe shton rrezikun e përmbytjeve në zonat më të ulëta. Masat e përshtatjes duhet të përfshijnë drenazh, stabilizim shpatesh, mbjellje me specie vendase, ndalimin e ndërtimeve në zona me risk të lartë dhe përfshirjen e hartave të rrëshqitjeve në planifikimin territorial.

5.1.6 Ndikimet klimatike mbi cilësinë e ujit, tokës dhe ajrit

Ndryshimet klimatike mund të përkeqësojnë ndotjen ekzistuese ose të krijojnë kushte për shpërndarje më të gjerë të ndotësve. Reshjet intensive mund të transportojnë ndotës nga sipërfaqet urbane, bujqësore ose industriale drejt kanaleve, ujërave sipërfaqësore dhe tokave bujqësore. Thatësira mund të rrisë përqendrimin e ndotësve në ujëra dhe të përkeqësojë cilësinë e ajrit për shkak të pluhurit, temperaturave të larta dhe zjarreve.

Për Patosin, ky risk ka rëndësi të veçantë për shkak të aktivitetit hidrokarbur dhe nevojës për monitorim të vazhdueshëm të tokës, ujit dhe ajrit. Monitorimi duhet të përfshijë parametrat bazë të cilësisë së ujit, ndotjen organike, hidrokarburet, metalet e rënda, grimcat në ajër dhe zonat ku komuniteti raporton shqetësime shëndetësore ose mjedisore. Të dhënat duhet të publikohen në mënyrë të kuptueshme për komunitetin dhe të përdoren për vendimmarrje.

5.1.7 Tabela e indikatorëve për monitorimin e rreziqeve klimatike

Rreziku	Indikatorë monitorimi	Institucioni kryesor
Përmbytjet	Numri i ngjarjeve të përmbytjes; sipërfaqja e tokës së përmbytur; gjatësia e kanaleve të pastruara; numri i banesave ose rrugëve të prekura.	Bashkia Patos, bordet e kullimit, AKMC.
Thatësira	Ditët pa reshje; niveli i rezervuarëve; sipërfaqja bujqësore pa ujitje; kërkesa për ujë në periudhën verore.	Bashkia Patos, strukturat e bujqësisë dhe ujitjes.
Valët e të nxehtit	Ditët me temperatura shumë të larta; kërkesa për energji; rastet shëndetësore të lidhura me të nxehtin; hapësirat publike me hijezim.	Bashkia Patos, qendrat shëndetësore.

Zjarret	Numri i vatrave të zjarrit; sipërfaqja e djegur; koha mesatare e reagimit; numri i fushatave parandaluese.	MZSH, Bashkia Patos, strukturat pyjore.
Rrëshqitjet dhe erozioni	Numri i vatrave aktive; rrugët ose banesat e prekura; sipërfaqja e stabilizuar; sedimentimi në kanale e rezervuarë.	Bashkia Patos, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
Cilësia e mjedisit	Numri i analizave të ajrit, ujit dhe tokës; tejkalimet e normave; raportimet e komunitetit; zonat e rehabilituara.	Bashkia Patos, AKM, operatorët ekonomikë.

5.2 Informacion mbi klimën

Informacioni klimatik për Planin Vendor të Përshtatjes të Bashkisë Patos mbështetet në Planin Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë 2026-2036, në të dhënat dhe udhëzimet e procesit kombëtar të përshtatjes të mbështetur nga UNDP dhe Fondi i Gjelbër për Klimën, si dhe në përvojën e planeve vendore të përshtatjes të hartuara për bashkitë e tjera. Këto dokumente theksojnë se Shqipëria është e ekspozuar ndaj valëve të të nxehtit, thatësirave, përmbytjeve, stuhive, zjarreve dhe rritjes së nivelit të detit, ndërsa në nivel vendor kërkohet përkthimi i këtyre rreziqeve në masa konkrete për bujqësinë, energjinë, transportin, zhvillimin urban dhe turizmin.

5.2.1 Ndryshimet aktuale klimatike në Shqipëri

Të dhënat e përdorura në Planin Kombëtar të Përshtatjes tregojnë se Shqipëria po përjeton rritje të temperaturave mesatare, zgjatje të periudhave të nxehta dhe rritje të shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme. Ndikimet më të dukshme janë valët e të nxehtit, thatësirat sezonale, reshjet intensive në periudha të shkurtra dhe përmbytjet e shpejta, të cilat prekin veçanërisht popullsinë rurale, bujqësinë, furnizimin me ujë, infrastrukturën dhe shërbimet publike. Në territorin e Patosit, këto prirje lidhen me uljen e sigurisë ujore për bujqësinë, mbingarkimin e kanaleve kulluese, rritjen e riskut të zjarreve në zonat kodrinore dhe përkeqësimin e cilësisë së ajrit, ujit e tokës në zona me ndikim industrial.

Ndryshimi aktual klimatik	Ndikimi në Shqipëri	Implikimi për Bashkinë Patos
Rritje e temperaturave dhe valë të të nxehtit	Rritje e stresit termik, kërkesës për energji dhe riskut shëndetësor.	Nevojë për hijezim urban, termoizolim të objekteve publike dhe protokolle për të moshuarit e grupet e cenueshme.
Reshje intensive dhe përmbytje	Dëmtime në infrastrukturë, toka bujqësore dhe shërbime publike.	Prioritet për pastrim kanalesh, kontroll të pusetave, mirëmbajtje të rrugëve dhe hartëzim të zonave fushore të ekspozuara.

Thatësira sezonale	Presion mbi ujitjen, furnizimin me ujë dhe prodhimin bujqësor.	Nevojë për ujitje eficiente, menaxhim rezervuarësh, kultura më rezistente dhe planifikim të kërkesës për ujë.

5.2.2 Parashikimet klimatike për të ardhmen për Shqipërinë

Parashikimet klimatike të përdorura në procesin kombëtar të përshtatjes tregojnë se Shqipëria pritet të përballet me rritje të mëtejshme të temperaturave, shtim të ditëve të nxehta, zgjatje të periudhave të thata dhe ndryshim të shpërndarjes sezonale të reshjeve. Edhe kur totali vjetor i reshjeve mund të ulet ose të luhatet, intensiteti i reshjeve ekstreme mund të rritet, duke krijuar më shumë risk për përmbytje të shpejta, erozion dhe dëmtime infrastrukturore. Për Bashkinë Patos, kjo do të thotë se planifikimi duhet të kalojë nga reagimi pas ngjarjes drejt parandalimit: investime në kullim, mirëmbajtje të rrugëve dhe tombinove, menaxhim uji në bujqësi, gjelbërim urban, mbrojtje nga zjarret dhe protokolle për vazhdimësinë e shërbimeve publike.

Tendenca e parashikuar	Rreziku kryesor	Përgjigjja e rekomanduar vendore
Rritje e temperaturave mesatare dhe ekstreme	Valë të të nxehtit, rritje e kërkesës për energji dhe rrezik shëndetësor.	Gjelbërim, hijezim, qendra freskimi, termoizolim, komunikim publik dhe mbështetje për grupet e cenueshme.
Zgjatje e periudhave të thata	Mungesë uji për bujqësi, blegtori dhe përdorime familjare.	Rehabilitim i ujitjes, kursim uji, monitorim rezervuarësh, kultura rezistente dhe skema të thjeshta ujitjeje eficiente.
Rritje e intensitetit të reshjeve ekstreme	Përmbytje lokale, erozion, dëmtim rrugësh, kanalesh dhe tokash bujqësore.	Pastrimi i kanaleve, rritja e kapacitetit kullues, sipërfaqe të përshkueshme, kontroll i ndërtimeve dhe sisteme paralajmërimi.

5.2.3 Parashikimet e reshjeve

Parashikimet e reshjeve për Shqipërinë tregojnë rritje të pasigurisë sezonale: periudha më të gjata pa reshje gjatë verës dhe episode më intensive reshjesh në periudha të shkurtra, veçanërisht në sezonet e tranzicionit dhe dimrit. Kjo sjell dy sfida paralele për Patosin: mungesë uji në periudha të thata dhe rritje të përmbytjeve e erozionit kur reshjet janë të dendura. Për këtë arsye, menaxhimi i reshjeve nuk duhet të kufizohet te reagimi emergjent, por duhet të përfshijë projektim të qëndrueshëm të kanaleve, mirëmbajtje parandaluese, reduktim të mbetjeve në rrjedhat ujore, ruajtje të lagështisë së tokës dhe koordinim me fermerët për periudhat kritike të ujitjes.

Skenari i reshjeve	Ndikimi i mundshëm	Masa për Patosin
Reshje intensive në periudha të shkurtra	Përmbytje urbane dhe rurale, bllokim kanalesh, dëmtime në rrugë dhe toka bujqësore.	Pastrimi sezonal i kanaleve, kontrolli i pusetave, inventarizimi i pikave të përmbytjes dhe ndërhyrje në tombino.
Periudha të gjata pa reshje	Stres ujor, humbje prodhimi, degradim i tokës dhe rritje e riskut të zjarreve.	Plan ujitjeje, kursim uji, mulçim, kultura më rezistente, kontroll i zjarreve dhe fushata ndërgjegjësimi.
Ndryshim i shpërndarjes sezonale	Vështirësi në planifikimin bujqësor, mirëmbajtjen e kanaleve dhe menaxhimin e rezervuarëve.	Kalendar vjetor i mirëmbajtjes, monitorim i reshjeve, bashkëpunim me fermerët dhe përdorim i të dhënave për vendimmarrje.

6. Vlerësimi i riskut dhe cenueshmërisë

Vlerësimi i riskut mbështetet në kombinimin e ekspozimit ndaj rrezikut, ndjeshmërisë së sektorëve dhe kapacitetit për përshtatje. Për Patosin, ekspozimi më i lartë lidhet me përmbytjet në zonat fushore dhe pranë kanaleve, riskun teknologjik në zonat e ndikuara nga hidrokarburet, rrëshqitjet në zonat kodrinore, zjarret në territoret pyjore e bujqësore dhe valët e të nxehtit në zonat urbane.

Kapaciteti për përshtatje duhet të forcohet përmes përmirësimit të të dhënave, ngritjes së sistemeve të paralajmërimit të hershëm, pajisjes së strukturave të emergjencës, investimeve parandaluese, edukimit të komunitetit dhe integrimit të riskut në buxhet dhe planifikim.

Metodologjia e vlerësimit të riskut ndjek logjikën e përdorur në Planin Kombëtar të Përshtatjes dhe në planet vendore të mbështetura nga UNDP: risku vlerësohet si kombinim i rrezikut klimatik, ekspozimit të popullsisë dhe aseteve, cenueshmërisë sociale, ekonomike e mjedisore dhe kapacitetit për përshtatje. Për secilin sektor, vlerësimi duhet të përdorë të dhëna vendore për ngjarjet e kaluara, harta të riskut, inventar të aseteve kritike, konsultime me komunitetin dhe vlerësim teknik të infrastrukturës.

Rreziku	Ekspozimi në Patos	Cenueshmëria	Niveli orientues i riskut
Përmbytje dhe reshje intensive	Zona fushore, kanale kulluese, rrugë rurale, toka bujqësore dhe vendbanime pranë rrjetit ujor.	Mirëmbajtje e pamjaftueshme, bllokim nga mbetjet, kapacitet i kufizuar kullues dhe varësi nga bujqësia.	**I lartë**
Thatësira dhe mungesa e ujit	Fermerë, blegtori, rezervuarë, ujitje dhe	Varësi ekonomike nga bujqësia, humbje në rrjet, kapacitet i kufizuar për	**I lartë**

	furnizim me ujë në periudha vere.	investime dhe të dhëna të pamjaftueshme ujore.	
Valë të të nxehtit	Qendra urbane, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore dhe banesa me izolim të dobët.	Popullsi e moshuar, familje me të ardhura të ulëta, mungesë hijezimi dhe rritje e kostos së energjisë.	**Mesatar-i lartë**
Zjarre në pyje dhe toka bujqësore	Zona kodrinore, pyje, kullota, ullishte dhe sipërfaqe bujqësore.	Rrugë pyjore të kufizuara, djegie mbetjesh bujqësore, mungesë pikash uji dhe kapacitet i kufizuar reagimi.	**Mesatar-i lartë**
Risk teknologjik dhe ndotje e përkeqësuar nga klima	Zona të ndikuara nga aktiviteti hidrokarbur, toka bujqësore dhe kanale pranë burimeve të ndotjes.	Monitorim i kufizuar, ekspozim i komunitetit, përhapje e ndotësve gjatë përmbytjeve dhe përqendrim gjatë thatësirës.	**I lartë**

Prioriteti i përshtatjes	Veprimi kryesor	Tregues monitorimi
Ulja e riskut nga përmbytjet	Pastrimi dhe rehabilitimi i kanaleve, hartëzimi i pikave kritike dhe përmirësimi i drenazhit urban e rural.	Gjatësia e kanaleve të pastruara, numri i pikave kritike të trajtuara, dëmet e raportuara pas reshjeve.
Siguria ujore dhe bujqësia reziliente	Program për ujitje eficiente, monitorim rezervuarësh, analiza toke dhe mbështetje për kultura të përshtatura.	Sipërfaqja me ujitje eficiente, numri i fermerëve të trajnuar, analizat e tokës dhe humbjet bujqësore nga thatësira.
Mbrojtja e shëndetit dhe grupeve të cenueshme	Lista e grupeve në nevojë, protokolle për valët e të nxehtit, evakuim dhe komunikim i riskut.	Numri i personave të regjistruar për asistencë, njoftimet publike, ushtrimet praktike dhe rastet shëndetësore të raportuara.
Monitorimi i ndotjes dhe riskut teknologjik	Analiza periodike të ajrit, ujit dhe tokës, protokolle reagimi dhe publikim i të dhënave për komunitetin.	Numri i analizave, tejkalimet e normave, zonat e rehabilituara dhe raportimet e komunitetit.

7. Analiza sektoriale

Ky kapitull paraqet analizën sektoriale të ndikimeve klimatike për Bashkinë Patos, duke përdorur si bazë të dhënat dhe shërbimet zyrtare të Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO), veçanërisht rrjetin kombëtar të monitorimit meteorologjik dhe hidrologjik, Buletinin e Rreziqeve Natyrore, parashikimet hidrologjike dhe meteorologjike, si dhe informacionin për rreziqet nga reshjet, përmbytjet e shpejta, rrëshqitjet, zjarret në pyje, temperaturat e larta dhe thatësira hidrologjike. Për Patosin, analiza sektoriale fokusohet në rreziqet që kanë probabilitet dhe ndikim më të lartë: reshjet intensive, përmbytjet lokale, periudhat e thata, valët e të nxehtit, zjarret, erozioni/rrëshqitjet dhe përkeqësimi i ndotjes gjatë ngjarjeve ekstreme.

Sipas IGJEO-s, Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore monitoron dhe analizon të dhënat hidrologjike e meteorologjike në kohë reale nga stacionet automatike dhe manuale, përdor modele meteorologjike dhe hidrologjike, si dhe modele ndërkombëtare për parashikimin e motit, përmbytjeve dhe zjarreve në pyje. Buletini ditor i Rreziqeve Natyrore jep informacion për reshjet e pritshme, rreziqet hidrologjike, përmbytjet e shpejta, përmbytjet lumore, rrëshqitjet dhe zjarret në pyje, me horizont parashikimi 36-orësh. Këto të dhëna duhet të përdoren nga Bashkia Patos për të ndërtuar regjistrin vendor të riskut dhe mundësive, si dhe për të orientuar masat sektoriale në shëndet, infrastrukturë, bujqësi, ekonomi, mjedis natyror dhe asetet bashkiake.

Burimi zyrtar i të dhënave	Treguesit kryesorë	Përdorimi në analizën sektoriale
IGJEO – Rrjeti Kombëtar i Monitorimit Meteorologjik	Temperatura, reshjet, era, ngjarjet ekstreme dhe vrojtimet meteorologjike.	Vlerësim i valëve të të nxehtit, reshjeve intensive, thatësirës dhe ndikimeve në shëndet, bujqësi e energji.
IGJEO – Rrjeti Kombëtar i Monitorimit Hidrologjik	Nivele dhe prurje ujore, rrezik përmbytjeje, thatësirë hidrologjike dhe gjendje e baseneve.	Planifikim për kanalet kulluese, rezervuarët, ujitjen, paralajmërimin e hershëm dhe mbrojtjen civile.
Buletini i Rreziqeve Natyrore i IGJEO-s	Rrezik meteorologjik, hidrologjik, përmbytje të shpejta, rrëshqitje dhe zjarre në pyje.	Aktivizim i strukturave vendore, njoftim i komunitetit, gatishmëri e shërbimeve dhe prioritet për zonat kritike.

DRAFT

7.0 Metodologjia me tre hapa për analizën sektoriale

Hapi 1: Vlerësimi i ndryshimeve klimatike aktuale dhe të ardhshme. Ky hap synon të përkthejë informacionin meteorologjik dhe hidrologjik në tregues praktikë për vendimmarrjen vendore. Për Bashkinë Patos, vlerësimi duhet të bazohet në të dhënat e IGJEO-s për temperaturat, reshjet, erën, paralajmërimet hidrologjike, thatësirën hidrologjike, rrëshqitjet dhe zjarret në pyje; në të dhënat e INSTAT-it për popullsinë, moshën dhe shpërndarjen territoriale; si dhe në të dhënat e vetë bashkisë për dëmet, kanalet, rrugët, objektet publike dhe grupet e cenueshme. Buletini i Rreziqeve Natyrore i IGJEO-s përdor nivele rreziku "s'ka rrezik", "i ulët", "i moderuar" dhe "i lartë", ndërsa klasifikimi i reshjeve 24-orëshe ndahet në të dobëta 0-15 mm/24 orë, mesatare 15-45 mm/24 orë, intensive 45-90 mm/24 orë dhe shumë intensive mbi 90 mm/24 orë.

Treguesi klimatik	Burimi zyrtar	Përdorimi në Patos
Temperaturat minimale/maksimale dhe ditët me nxehtësi ekstreme	IGJEO – Parashikimi meteorologjik dhe Buletini i Rreziqeve Natyrore.	Aktivizimi i protokolleve për valët e të nxehtit, shkollat, qendrat shëndetësore dhe grupet e cenueshme.
Reshjet 24-orëshe dhe intensiteti lokal	IGJEO – Buletini i Rreziqeve Natyrore; klasifikimi 0-15, 15-45, 45-90 dhe mbi 90 mm/24 orë.	Paralajmërim për përmbytje urbane/rurale, kontroll i kanaleve, tombinove, pusetave dhe rrugëve kritike.
Rreziku hidrologjik, përmbytjet e shpejta dhe rrëshqitjet	IGJEO – Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore.	Verifikim në terren në Zharrëz, Ruzhdie, Dukas, Belinë, Sheqishtë, Verbas dhe zonat pranë rrjetit kullues.
Rreziku nga zjarret në pyje	IGJEO – Buletini i Rreziqeve Natyrore dhe modelet ndërkombëtare të përdorura nga QKPMRN.	Gatishmëri e MZSH-së, kontroll i pikave të ujit, komunikim me fermerët dhe ndalim i djegieve të pakontrolluara.

Hapi 2: Identifikimi i risqeve dhe mundësive përkatëse. Në këtë hap, çdo sektor analizohet për të kuptuar se si rreziku klimatik shndërrohet në ndikim real mbi njerëzit, infrastrukturën, ekonominë, bujqësinë, mjedisin dhe asetet bashkiake. Për Bashkinë Patos, risqet kryesore janë përmbytjet nga reshjet intensive, mungesa e ujit në periudha të thata, valët e të nxehtit, zjarret në pyje dhe toka bujqësore, rrëshqitjet/erozioni dhe përkeqësimi i ndotjes në zonat me ndikim hidrokarbur. Mundësitë kryesore janë përmirësimi i kullimit, ujitjes eficiente, gjelbërimit urban, energjisë diellore në objekte publike, ripyllëzimit, sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe bujqësisë reziliente.

Sektori	Risku kryesor	Mundësia e përshtatjes	Burimi i të dhënave

Shëndeti dhe komuniteti	Valë të të nxehtit, përmbytje, ndotje dhe ndërprerje shërbimesh.	Lista të grupeve të cenueshme, qendra freskimi, komunikim publik dhe protokolle evakuimi.	INSTAT Censi 2023, shërbimet sociale, IGJEO.
Infrastruktura	Dëmtime nga përmbytjet, erozioni, rrëshqitjet dhe temperaturat e larta.	Projektim rezilient, pastrim i kanaleve, kontroll i tombinove dhe mirëmbajtje parandaluese.	IGJEO, regjistri vendor i dëmeve, ASIG, AKMC.
Bujqësia dhe uji	Thatësirë, mungesë ujitjeje, përmbytje të tokave dhe humbje prodhimi.	Ujitje eficiente, kultura rezistente, analiza toke dhe plan menaxhimi uji.	IGJEO hidrologji, sektori bujqësor vendor, AREB.
Mjedisi, pyjet dhe biodiversiteti	Zjarre, erozion, ndotje e ujit/tokës dhe degradim i habitatit.	Ripyllëzim, breza mbrojtës, zona tampon, kontroll i burimeve të ndotjes.	IGJEO, AKM, Bashkia Patos.

Hapi 3: Pikëzimi i risqeve. Pikëzimi përdoret për të prioritizuar masat dhe për të lidhur analizën sektoriale me planin e veprimit. Për çdo risk vlerësohen katër elemente: probabiliteti i ndodhjes, ndikimi mbi njerëzit dhe asetet, cenueshmëria e sektorit dhe kapaciteti ekzistues për reagim/përshtatje. Shkalla orientuese është 1-5, ku 1 tregon nivel shumë të ulët dhe 5 nivel shumë të lartë. Niveli i përgjithshëm i riskut llogaritet si kombinim cilësor i këtyre faktorëve dhe përdoret për të ndarë masat në prioritete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Risku	Probabiliteti	Ndikimi	Kapaciteti aktual	Prioriteti
Përmbytje dhe reshje intensive	4	5	3	**Shumë i lartë**
Thatësira dhe mungesa e ujit	4	4	3	**I lartë**
Valë të të nxehtit	4	4	2	**I lartë**
Zjarre në pyje dhe toka bujqësore	4	4	3	**I lartë**
Ndotje e përkeqësuar nga klima	3	5	2	**I lartë**

7.1 Njerëzit, shëndeti, komunitetet dhe mjedisi i ndërtuar

Valët e të nxehtit, përmbytjet, ndotja e ajrit dhe ujit, ndërprerjet e shërbimeve dhe dëmtimi i ndërtesave ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve. Prioritet duhet t'u jepet shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, banesave të vjetra, familjeve me të ardhura të ulëta dhe personave me nevoja të veçanta.

Rreziku sipas të dhënave IGJEO	Ndikimi në Patos	Të dhëna që duhen ndjekur
Temperatura të larta dhe valë të të nxehtit	Rritje e riskut për të moshuarit, fëmijët, personat me sëmundje kronike dhe familjet në banesa me izolim të dobët.	Temperatura maksimale ditore, numri i ditëve me temperatura ekstreme, njoftimet e IGJEO-s dhe rastet shëndetësore të raportuara.
Reshje intensive dhe përmbytje urbane	Dëmtime në banesa, rrugë, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore dhe bllokim i lëvizjes në lagje e fshatra.	Sasia e reshjeve 24-orëshe, intensiteti i reshjeve, pikat e përmbytjes, gjendja e kanalizimeve dhe njoftimet e buletinit.
Ndotje e ajrit/ujit pas ngjarjeve ekstreme	Rritje e riskut shëndetësor në zona pranë kanaleve, mbetjeve urbane, ujërave të ndotura dhe ndikimit hidrokarbur.	Raportime komunitare, analiza uji/toke/ajri pas përmbytjeve, vendndodhje e pikave të ndotjes dhe ndërhyrjet e pastrimit.

Tabela 7.1. Risqet për njerëzit, shëndetin, komunitetet dhe mjedisin e ndërtuar dhe pikëzimi përkatës

Risku	**Pikëzimi i riskut dhe veprimi**	**Komente/Narrativa e riskut**
Rritja e temperaturave dhe valët e të nxehtit mbi të moshuarit, fëmijët dhe personat me sëmundje kronike.	**I lartë – nevojiten veprime**	Patosi ka përqindje të lartë të popullsisë 65+ dhe ndërtesa publike/banesa që kërkojnë hijezim, ventilim dhe termoizolim. Masa prioritare: protokoll për valët e të nxehtit, lista e grupeve të cenueshme dhe qendra freskimi.
Përmbytjet urbane/rurale që prekin banesa, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore dhe lëvizjen e komunitetit.	**Shumë i lartë – nevojiten veprime urgjente**	Reshjet intensive dhe kanalet/pusetat e bllokuara mund të ndërpresin shërbimet bazë. Masa prioritare: pastrim kanalesh, hartëzim i pikave të përmbytjes dhe plan evakuimi për objektet publike.
Përkeqësimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës pas përmbytjeve, zjarreve ose thatësirës në zona me ndikim hidrokarbur.	**I lartë – nevojitet monitorim dhe veprim**	Risku klimatik mund të shpërndajë ndotës gjatë përmbytjeve ose t'i përqendrojë gjatë thatësirës. Masa prioritare: analiza periodike të ajrit, ujit dhe tokës dhe publikim i rezultateve.

7.2 Infrastruktura

Aseti/infrastruktura	Rreziku klimatik	Referenca e të dhënave dhe veprimi
Rrugë, ura dhe tombino	Reshje intensive, përmbytje të shpejta, erozion dhe rrëshqitje.	Buletini i IGJEO-s për rrezikun hidrologjik dhe rrëshqitjet; inspektim para/pas reshjeve dhe hartëzim i pikave kritike.
Kanale kulluese dhe rezervuarë	Mbingarkim gjatë reshjeve, sedimentim, bllokim nga mbetjet dhe mungesë kapaciteti në thatësirë.	Të dhëna hidrologjike IGJEO dhe regjistër vendor i pastrimit; mirëmbajtje sezonale dhe kontroll i nivelit të ujit.
Ndërtesa publike	Temperatura të larta, lagështi, reshje intensive dhe ndërprerje energjie.	Të dhënat meteorologjike IGJEO për temperatura/reshje; auditim teknik, hijezim, termoizolim dhe plan vijimësie shërbimi.

Tabela 7.2. Risqet për infrastrukturën dhe pikëzimi përkatës

Risku	**Pikëzimi i riskut dhe veprimi**	**Narrativa e riskut**
Dëmtimi i rrugëve, urave, tombinove dhe kanaleve nga reshjet intensive, përmbytjet dhe erozioni.	**Shumë i lartë – nevojiten veprime**	Ndikimi mund të ndërpresë aksesin në shkolla, qendra shëndetësore, toka bujqësore dhe shërbime emergjente. Kërkohet inventar i pikave kritike dhe inspektim para/pas reshjeve.
Mbingarkimi i rrjetit të kanalizimeve, pusetave dhe kanaleve urbane gjatë reshjeve afatshkurtra me intensitet të lartë.	**I lartë – nevojiten veprime dhe monitorim**	Përmbytjet lokale rriten nga mbetjet dhe sedimentimi. Masat: pastrim periodik, rritje e kapacitetit kullues dhe kontroll i ndërtimeve në zona me risk.
Mbinxehja, lagështia dhe ndërprerja e energjisë në ndërtesa publike gjatë valëve të të nxehtit dhe ngjarjeve ekstreme.	**Mesatar-i lartë – monitorim dhe ndërhyrje graduale**	Shkollat, kopshtet, administrata dhe qendrat shëndetësore kërkojnë auditim teknik, termoizolim, hijezim dhe plan vijimësie shërbimi.

7.3 Bujqësia, uji dhe ekonomia vendore

Nënsektori	Ndikimi klimatik	Tregues zyrtarë dhe masa

Kulturat bujqësore dhe drufrutorët	Stres nga nxehtësia, mungesë uji, humbje prodhimi dhe rrezik nga reshjet intensive në faza kritike.	Temperatura, reshje dhe thatësirë hidrologjike nga IGJEO; kalendar ujitjeje, kultura rezistente dhe këshillim për fermerët.
Ujitja dhe kullimi	Mungesë uji në verë dhe përmbytje/sedimentim gjatë reshjeve intensive.	Monitorim hidrologjik IGJEO, nivele rezervuarësh, regjistër pastrimi kanalesh dhe investime në ujitje eficiente.
Biznesi dhe ekonomia rurale	Ndërprerje transporti, rritje e kostove të energjisë, dëme në prodhim dhe ulje e të ardhurave familjare.	Njoftimet e rrezikut nga IGJEO dhe regjistri vendor i dëmeve; sigurim prodhimi, diversifikim dhe rrugë alternative tregtimi.

Tabela 7.3. Risqet për bujqësinë, ujin dhe ekonominë vendore dhe pikëzimi përkatës

Risku	**Pikëzimi i riskut dhe veprimi**	**Narrativa e riskut**
Mungesa e ujit për ujitje dhe stres i lartë i kulturave bujqësore gjatë thatësirave verore.	**I lartë – nevojiten veprime**	Fermerët e vegjël dhe ekonomitë rurale varen nga ujitja dhe prodhimi sezonal. Masa: kalendar ujitjeje, rehabilitim kanalesh, kultura rezistente dhe kursim uji.
Përmbytja e tokave bujqësore, dëmtimi i prodhimit dhe sedimentimi i kanaleve gjatë reshjeve intensive.	**Shumë i lartë – nevojiten veprime urgjente**	Rreziku prek drejtpërdrejt të ardhurat familjare dhe sigurinë ushqimore. Masa: pastrim kullimi, planifikim i mbjelljeve, sigurim prodhimi dhe regjistër dëmesh.
Ndërprerje e zinxhirit lokal të furnizimit, transportit dhe tregtimit të produkteve nga dëmtimi i rrugëve dhe ngjarjet ekstreme.	**Mesatar-i lartë – monitorim dhe masa parandaluese**	Rrugët rurale dhe tregtimi janë të lidhura me qëndrueshmërinë e ekonomisë bujqësore. Masa: rrugë alternative, mirëmbajtje para sezonit të reshjeve dhe mbështetje për tregje lokale.

7.4 Mjedisi natyror, pyjet dhe biodiversiteti

Elementi natyror	Rreziku kryesor	Të dhëna dhe masa përshtatjeje

Pyje, kullota dhe zona kodrinore	Zjarre në pyje, thatësirë, degradim bimësie dhe erozion.	Buletini i IGJEO-s për rrezikun nga zjarret në pyje; breza mbrojtës, pika uji, rrugë pyjore dhe ripyllëzim me specie vendase.
Tokat bujqësore dhe shpatet	Rrëshqitje, erozion, humbje pjellorie dhe sedimentim i kanaleve.	Njoftimet IGJEO për rrëshqitje dhe reshje; stabilizim shpatesh, drenazh, mbulesë bimore dhe praktika konservuese të tokës.
Ujërat sipërfaqësore dhe habitatet	Ndotje nga përmbytjet, ulje prurjesh në thatësirë dhe humbje shërbimesh ekosistemike.	Monitorim hidrologjik dhe analiza cilësie uji; pastrim kanalesh, zona tampon të gjelbra dhe kontroll i burimeve të ndotjes.

Tabela 7.4. Risqet për mjedisin natyror, pyjet dhe biodiversitetin dhe pikëzimi përkatës

Risku	**Pikëzimi i riskut dhe veprimi**	**Narrativa e riskut**
Zjarret në pyje, kullota dhe toka bujqësore gjatë periudhave të nxehta dhe të thata.	**I lartë – nevojiten veprime**	Zonat kodrinore dhe pyjore janë të ekspozuara ndaj zjarreve, sidomos kur ka thatësirë dhe djegie të pakontrolluar të mbetjeve bujqësore. Masa: breza mbrojtës, pika uji dhe fushata parandaluese.
Erozioni dhe rrëshqitjet në shpate, me ndikim në toka bujqësore, rrugë dhe kanale.	**I lartë – veprime dhe njohje më e thelluar**	Reshjet intensive rrisin rrjedhjen sipërfaqësore dhe sedimentimin. Masa: stabilizim shpatesh, drenazh, mbulesë bimore dhe zgjidhje të bazuara në natyrë.
Ndotja e ujërave dhe tokës gjatë përmbytjeve ose thatësirave në zona me burime ndotjeje.	**I lartë – monitorim dhe masa korrigjuese**	Ujërat sipërfaqësore mund të transportojnë ndotës drejt kanaleve dhe tokave bujqësore. Masa: zona tampon të gjelbra, analiza cilësie dhe kontroll i burimeve të ndotjes.

7.5 Asetet dhe veprimtaritë e bashkisë

Bashkia duhet të vlerësojë cenueshmërinë e ndërtesave, pajisjeve, mjeteve, rrjeteve të shërbimeve, kapaciteteve të stafit dhe procedurave operative ndaj ngjarjeve klimatike. Përgatitja e planeve të vijimësisë së shërbimit dhe protokolleve të emergjencës është thelbësore për funksionimin e administratës gjatë krizave.

Aseti/veprimtaria bashkiake	Cenueshmëria	Përdorimi i të dhënave IGJEO

Administrata dhe shërbimet publike	Ndërprerje pune gjatë përmbytjeve, zjarreve, valëve të të nxehtit dhe ndërprerjeve të energjisë.	Aktivizim i planit të vijimësisë kur buletini i IGJEO-s sinjalizon rrezik të lartë; njoftim publik dhe staf në gatishmëri.
MZSH, emergjencat civile dhe njësitë administrative	Kapacitet i kufizuar për reagim të njëkohshëm ndaj përmbytjeve, zjarreve, rrëshqitjeve dhe ndotjes.	Përdorim ditor i Buletinit të Rreziqeve Natyrore, përgatitje e listës së pikave kritike dhe koordinim me AKMC.
Planifikimi, buxhetimi dhe projektet	Investime që nuk marrin parasysh intensitetin e reshjeve, nxehtësinë, erozionin ose thatësirën mund të dëmtohen shpejt.	Përdorim i të dhënave historike dhe parashikimeve të IGJEO-s për projektim, prioritizim dhe argumentim financimi.

Tabela 7.5. Risqet për asetet dhe veprimtaritë e bashkisë dhe pikëzimi përkatës

Risku	**Pikëzimi i riskut dhe veprimi**	**Narrativa e riskut**
Ndërprerja e shërbimeve bashkiake gjatë përmbytjeve, zjarreve, valëve të të nxehtit dhe ndërprerjeve të energjisë.	**I lartë – nevojiten plane vijimësie**	Administrata, MZSH, shërbimet publike dhe njësitë administrative duhet të kenë procedura të qarta për mobilizim, komunikim dhe punë në kushte emergjence.
Dëmtimi i objekteve publike, pajisjeve, rrjeteve dhe mjeteve bashkiake nga ngjarje ekstreme.	**Mesatar-i lartë – monitorim dhe investime graduale**	Kërkohet inventar i aseteve, vlerësim i ekspozimit, auditim teknik dhe plan mirëmbajtjeje për objektet kritike.
Mungesa e të dhënave të konsoliduara për ngjarjet klimatike, dëmet, kostot dhe masat e marra.	**I lartë – nevojitet sistem raportimi**	Pa regjistër të përditësuar të dëmeve dhe masave, prioritizimi i investimeve mbetet i vështirë. Masa: sistem i centralizuar raportimi dhe raport vjetor klimatik.

8. Plani Vendor i Veprimit 2027-2036

Plani i veprimit organizohet në katër faza zbatimi: faza fillestare 2027-2028, faza e konsolidimit 2029-2031, faza e investimeve të zgjeruara 2032-2034 dhe faza e vlerësimit e rishikimit 2035-2036.

Fusha	Masa prioritare	Afati	Përgjegjës kryesor
Qeverisja	Krijimi i grupit drejtues për PNK dhe pikës së kontaktit për klimën.	2026	Bashkia Patos
Të dhënat dhe risku	Përditësimi i vlerësimit vendor të riskut dhe krijimi i hartës së cenueshmërisë klimatike.	2027-2028	Bashkia Patos, AKMC, ASIG
Përmbytjet	Pastrimi dhe rehabilitimi i kanaleve, vlerësimi i digave dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm.	2027-2031	Bashkia Patos, bordet e kullimit
Risk teknologjik	Hartëzim i hot-spoteve, monitorim i ajrit, ujit dhe tokës dhe protokolle reagimi.	2027-2034	Bashkia Patos, AKM, operatorë ekonomikë
Zjarret	Rrugë pyjore, korridore mbrojtëse, pajisje për MZSH dhe fushata ndërgjegjësimi.	2027-2036	Bashkia Patos, MZSH
Bujqësia	Skema ujitjeje eficiente, analiza toke, menaxhim i mbetjeve bujqësore dhe mbështetje për fermerët.	2028-2036	Bashkia Patos, fermerë, institucione bujqësore
Energjia	Auditime energjetike, termoizolim, ndriçim LED dhe panele fotovoltaike në objekte publike.	2027-2036	Bashkia Patos
Shëndeti dhe komuniteti	Plane evakuimi, komunikim publik, trajnime dhe mbështetje për grupet e cenueshme.	2027-2036	Bashkia Patos, qendrat shëndetësore, shkollat
Monitorimi	Raport vjetor i zbatimit dhe rishikim i planit në fund të periudhës.	Çdo vit	Bashkia Patos

Masa	Të dhënat që e justifikojnë	Rezultati i pritshëm	Referenca
Sistem vendor paralajmërimi dhe	Buletini i IGJEO-s klasifikon reshjet dhe rrezikun hidrologjik për	Njoftime më të shpejta, aktivizim i shërbimeve publike dhe ulje e dëmeve në	IGJEO, Parashikimi Hidrologjik dhe

reagimi për reshje intensive	çdo qark me horizont 36-orësh.	rrugë, kanale e banesa.	Meteorologjik, 2026.
Program për ujitje eficiente dhe menaxhim të thatësirës	Parashikimet kombëtare të përshtatjes tregojnë rritje të temperaturave dhe zgjatje të periudhave të thata.	Ulja e humbjeve bujqësore, ruajtja e rezervuarëve dhe përdorimi më eficient i ujit.	Plani Kombëtar i Përshtatjes 2026-2036; UNDP LAP, 2026.
Gjelbërim urban dhe hijezim i objekteve publike	Censi 2023 tregon 4,236 banorë 65+ në Patos, grup shumë i ndjeshëm ndaj valëve të të nxehtit.	Ulja e stresit termik në shkolla, kopshte, qendra shëndetësore dhe hapësira publike.	INSTAT, Censi 2023; PKP 2026-2036.

9. Qeverisja, monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi i planit do të koordinohet nga Bashkia Patos përmes strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile, planifikimin territorial, mjedisin, pyjet, bujqësinë, financën dhe shërbimet publike. Grupi drejtues do të ndjekë progresin, do të koordinojë institucionet partnere dhe do të përgatisë raportin vjetor të monitorimit.

- Raportim vjetor për zbatimin e masave, fondet, rezultatet dhe pengesat.
- Rishikim i riskut dhe cenueshmërisë të paktën çdo tre vjet.
- Përditësim i planit në varësi të të dhënave të reja klimatike dhe ngjarjeve të ndodhura.
- Publikim i informacionit kryesor për komunitetin dhe Këshillin Bashkiak.
- Integrim i treguesve të planit në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe në planet sektoriale të bashkisë.

Monitorimi duhet të ndërtohet mbi katër burime të dhënash: buletinet dhe paralajmërimet e IGJEO-s, regjistrin vendor të dëmeve dhe ngjarjeve klimatike, të dhënat demografike e sociale të INSTAT-it dhe Bashkisë Patos, si dhe raportet sektoriale për bujqësinë, mjedisin, energjinë, transportin dhe shërbimet publike. Për çdo vit, raporti i monitorimit duhet të krahasojë numrin e paralajmërimeve, ngjarjeve të ndodhura, dëmeve të raportuara, fondeve të përdorura dhe masave të zbatuara.

Treguesi	Burimi	Frekuenca
Numri i buletineve IGJEO me rrezik të moderuar/lartë për Qarkun Fier	IGJEO – Buletini i Rreziqeve Natyrore	Ditor/mbledhje vjetore
Dëmet e raportuara nga përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet dhe thatësirat	Regjistri vendor i dëmeve, njësitë administrative, MZSH	Pas çdo ngjarjeje/vjetor

Popullsia e mbuluar nga paralajmërimi dhe komunikimi i riskut	Bashkia Patos, INSTAT, shkollat, qendrat shëndetësore	Vjetor

10. Tabelat e masave prioritare sipas sektorëve

Tabelat e masave prioritare duhet të përdoren si instrument pune për përgatitjen e projekteve, buxhetimin afatmesëm dhe aplikimet për financim. Çdo masë duhet të shoqërohet me burimin e të dhënave që e justifikon, indikatorin e matshëm, institucionin përgjegjës dhe raportimin vjetor. Nëse të dhënat nuk janë të disponueshme, masa e parë duhet të jetë krijimi i bazës së të dhënave përkatëse.

10.1 Masat për periudhën 2027-2036

Në vijim paraqiten 40 masa të plota prioritare për zbatimin e Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike për Bashkinë Patos 2027-2036, të strukturuara për përdorim në buxhetim, aplikime për financim, monitorim dhe raportim vjetor.

Nr.	Masa prioritare	Sektori	Prioriteti	Afati	Përgjegjës	Indikator monitorimi	Burim financimi
1	Krijimi i Grupit Drejtues për Klimën dhe caktimi i pikës së kontaktit për PVP-në.	Qeverisje	Shumë i lartë	2027	Bashkia Patos, Këshilli Bashkiak	Vendim i miratuar; pikë kontakti e caktuar; takime periodike.	Buxheti bashkiak, asistencë teknike.
2	Krijimi i regjistrit vendor të ngjarjeve klimatike, dëmeve dhe kostove.	Qeverisje dhe të dhëna	Shumë i lartë	2027 - 2028	Emergjencat civile, njësitë administrative	Regjistër funksional; numër ngjarjesh të regjistruara; raporte vjetore.	Buxheti bashkiak, AKMC, donatorë.
3	Hartëzimi i zonave të ekspozuara ndaj përmbytjeve në Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie.	Përmbytje	Shumë i lartë	2027 - 2028	Bashkia Patos, ASIG, AKMC	Harta të përditësuara; pika kritike të verifikuara në terren.	AKMC, buxheti bashkiak, projekte teknike.

4	Pastrimi dhe rehabilitimi periodik i kanaleve kulluese dhe pusetave urbane.	Infrastrukturë dhe përmbytje	Shumë i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, bordet e kullimit	Km kanale të pastruara; numër pusetash të mirëmbajtura; ulje e përmbytjeve lokale.	Buxheti bashkiak, PBA, fonde emergjence.
5	Rehabilitimi i tombinove, urave të vogla dhe pikave të shkarkimit në rrugët vendore.	Transport dhe infrastrukturë	Shumë i lartë	2027 - 2031	Bashkia Patos, shërbimet publike	Numër tombinosh të rehabilituara; rrugë kritike të aksesueshme gjatë reshjeve.	PBA, FZHR, fonde kombëtare.
6	Vendosja e një sistemi vendor paralajmërimi dhe komunikimi për reshje intensive.	Mbrojtje civile	Shumë i lartë	2027 - 2029	Bashkia Patos, AKMC, IGJEO	Protokoll njoftimi; numër njoftimesh; popullsi e mbuluar nga paralajmërimi.	AKMC, buxheti bashkiak, donatorë.
7	Përgatitja e planeve të evakuimit për zonat e ekspozuara ndaj përmbytjeve.	Mbrojtje civile	I lartë	2027 - 2030	Bashkia Patos, MZSH, njësitë administrative	Plane të miratuara; ushtrime praktike; itinerare evakuimi të publikuara.	Buxheti bashkiak, AKMC.
8	Program vendor për ujitje eficiente dhe menaxhim të thatësirës.	Bujqësi dhe ujë	Shumë i lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos, fermerë, AREB	Ha me ujitje eficiente; numër fermerësh të trajnuar; humbje të reduktuara nga thatësira.	Skema kombëtare bujqësore, PBA, donatorë.
9	Monitorimi i rezervuarëve, burimeve ujore dhe kërkesës për ujë gjatë verës.	Ujë	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, struktura ujitjeje	Raporte sezonale; nivele të regjistruara; plan shpërndarjeje uji.	Buxheti bashkiak, institucionet e ujit.
10	Analiza periodike e tokës në zona bujqësore dhe zona me ndikim hidrokarbur.	Bujqësi dhe mjedis	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, AKM, operatorë ekonomikë	Numër analizash; zona të monitoruara; rekomandime teknike për fermerët.	AKM, përgjegjësi mjedisore, buxheti bashkiak.
11	Mbështetje për kultura bujqësore rezistente ndaj	Bujqësi	I lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos,	Numër fermerësh përfitues; sipërfaqe	Skema bujqësore,

	thatësirës dhe praktikave klimat-smart.				AREB, fermerë	të mbjella me kultura rezistente.	IPARD, donatorë.
12	Promovimi i mulçimit, ruajtjes së lagështisë dhe punimit konservues të tokës.	Bujqësi dhe tokë	Mesatar-i lartë	2028 - 2036	AREB, Bashkia Patos	Fermerë të trajnuar; demonstrime në terren; ulje e humbjes së lagështisë.	Donatorë, programe bujqësore.
13	Menaxhimi i mbetjeve bujqësore pa djegie dhe fushata kundër zjarreve.	Bujqësi, pyje dhe zjarre	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, MZSH, fermerë	Fushata të realizuara; raste djegiesh të reduktuara; sipërfaqe të mbrojtura.	Buxheti bashkiak, MZSH, donatorë.
14	Ripyllëzim me specie vendase në zona kodrinore dhe shpate të degraduara.	Pyje dhe biodiversitet	I lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos, strukturat pyjore	Ha të ripyllëzuara; mbijetesë e fidanëve; ulje e erozionit.	Fondi i pyjeve, buxheti bashkiak, donatorë.
15	Krijimi i brezave kundër zjarrit dhe mirëmbajtja e rrugëve pyjore.	Pyje dhe zjarre	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, MZSH	Km breza kundër zjarrit; km rrugë pyjore të mirëmbajtura.	Buxheti bashkiak, MZSH, fonde pyjore.
16	Vendosja e pikave të furnizimit me ujë për ndërhyrje kundër zjarreve.	Mbrojtje civile dhe pyje	I lartë	2028 - 2034	Bashkia Patos, MZSH	Numër pikash uji; kohë reagimi e reduktuar; zona të mbuluara.	AKMC, PBA, donatorë.
17	Stabilizim shpatesh me zgjidhje bioinxhinierike dhe drenazh në zona me erozion.	Rrëshqitje dhe erozion	I lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos, institucione teknike	Sipërfaqe të stabilizuara; vatra erozioni të trajtuara; ulje sedimentimi.	FZHR, buxheti bashkiak, donatorë.
18	Përfshirja e hartave të riskut në lejet e zhvillimit dhe projektet infrastrukturore.	Planifikim territorial	Shumë i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, IVMT	Leje të kontrolluara për risk; projekte të rishikuara; zona të shmangura.	Buxheti bashkiak, asistencë teknike.

19	Rritja e sipërfaqeve të gjelbra, hijezimit dhe pemëzimit urban.	Zhvillim urban dhe shëndet	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos	m² hapësira të gjelbra; numër pemësh; zona publike me hijezim.	PBA, donatorë, partneritete komunitare.
20	Krijimi i qendrave freskuese dhe protokolleve për valët e të nxehtit.	Shëndet dhe komunitet	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, qendrat shëndetësore	Qendra të identifikuara; njoftime publike; persona të asistuar.	Buxheti bashkiak, shërbime sociale.
21	Krijimi i listës së grupeve të cenueshme për asistencë gjatë emergjencave klimatike.	Shërbime sociale	Shumë i lartë	2027 - 2036	Shërbimet sociale, njësitë administrative	Listë e përditësuar; persona të kontaktuar; plane asistence.	Buxheti bashkiak, programe sociale.
22	Trajnime për shkollat mbi përmbytjet, zjarret, thatësirën dhe valët e të nxehtit.	Arsim dhe ndërgjegjësim	Mesatar-i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, shkollat	Numër trajnimesh; nxënës të përfshirë; materiale informuese.	Buxheti bashkiak, MAS, donatorë.
23	Përgatitja e planeve të emergjencës për shkolla, kopshte dhe qendra shëndetësore.	Arsim, shëndet dhe mbrojtje civile	I lartë	2027 - 2030	Bashkia Patos, institucionet publike	Plane të miratuara; ushtrime praktike; staf i trajnuar.	Buxheti bashkiak, AKMC.
24	Termoizolim, ventilim dhe hijezim në shkolla, kopshte dhe objekte publike.	Ndërtesa publike dhe energji	I lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos	Numër objektesh të përmirësuara; ulje e konsumit energjetik; komfort termik më i mirë.	Fonde eficience energjetike, PBA, donatorë.
25	Auditim energjetik i ndërtesave publike dhe plan investimesh për eficiencë.	Energji	I lartë	2027 - 2030	Bashkia Patos	Auditime të përfunduara; plane investimi; kursime të vlerësuara.	Fondi i eficiencës energjetike, PBA.
26	Zëvendësimi gradual i ndriçimit	Energji dhe shërbime publike	Mesatar-i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos	Numër ndriçuesish LED; ulje e faturës	PBA, partneritete,

	publik me LED.					së energjisë; zona të mbuluara.	fonde energjie.
27	Instalimi gradual i paneleve fotovoltaike në objekte publike prioritare.	Energji e rinovueshme	I lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos	kË të instaluar; energji e prodhuar; ulje e kostove operative.	Fonde të gjelbra, PBA, donatorë.
28	Monitorimi periodik i cilësisë së ajrit në zonat urbane dhe pranë burimeve industriale.	Mjedis dhe shëndet	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, AKM	Numër matjesh; tejkalime të raportuara; informim publik.	AKM, buxheti bashkiak, operatorë ekonomikë.
29	Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe kanaleve pas përmbytjeve.	Ujë dhe mjedis	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, AKM	Analiza pas ngjarjeve ekstreme; zona të ndotura të identifikuara.	AKM, buxheti bashkiak, donatorë.
30	Rehabilitimi i pikave të ndotura dhe pastrimi i mbetjeve në kanale e hapësira publike.	Mbetje dhe mjedis	I lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, operatorë shërbimesh	Pika të pastruara; ton mbetje të larguara; ulje e bllokimeve në kanale.	Buxheti bashkiak, tarifat e shërbimit, donatorë.
31	Forcimi i ndarjes në burim, riciklimit dhe kompostimit për të ulur mbetjet që bllokojnë kanalet.	Mbetje urbane	Mesatar -i lartë	2028 - 2036	Bashkia Patos	Pika ndarje; sasi e ricikluar/kompostuar; fushata komunitare.	PBA, donatorë, partneritete lokale.
32	Përgatitja e planeve të vijimësisë së shërbimeve bashkiake gjatë emergjencave klimatike.	Administratë dhe shërbime	I lartë	2027 - 2030	Bashkia Patos	Plane të miratuara; staf i trajnuar; teste të kryera.	Buxheti bashkiak, AKMC.

33	Inventarizimi i aseteve kritike: rrugë, ura, shkolla, qendra shëndetësore, kanale dhe rezervuarë.	Të dhëna dhe infrastrukturë	Shumë i lartë	2027 - 2028	Bashkia Patos	Inventar i përfunduar; koordinata; gjendje teknike e vlerësuar.	Buxheti bashkiak, ASIG, donatorë.
34	Mirëmbajtja parandaluese e rrugëve rurale para sezonit të reshjeve.	Transport	I lartë	Çdo vit	Bashkia Patos, njësitë administrative	Km rrugë të mirëmbajtura; pika bllokimi të reduktuara; akses i siguruar.	PBA, fondet e rrugëve.
35	Sinjalistikë dhe informim publik për rrugët alternative gjatë përmbytjeve ose zjarreve.	Transport dhe komunikim	Mesatar -i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, policia bashkiake	Itinerare të publikuara; sinjalistikë e vendosur; njoftime gjatë emergjencave.	Buxheti bashkiak, AKMC.
36	Zhvillimi i turizmit natyror dhe kulturor me masa sigurie klimatike dhe menaxhim mbetjesh.	Turizëm dhe mjedis	Mesatar	2028 - 2036	Bashkia Patos, komuniteti lokal	Shtigje të mirëmbajtura; sinjalistikë; pika mbetjesh; vizitorë të informuar.	PBA, donatorë, programe turizmi.
37	Fushata komunitare për kursimin e ujit, parandalimin e zjarreve dhe mbrojtjen nga nxehtësia.	Ndërgjegjësim publik	I lartë	Çdo vit	Bashkia Patos, shkollat, OJF	Fushata të realizuara; materiale të shpërndara; komunitete të mbuluara.	Buxheti bashkiak, donatorë.
38	Trajnimi i stafit bashkiak për integrimin e riskut klimatik në projektim dhe prokurim.	Kapacitete institucionale	I lartë	2027 - 2032	Bashkia Patos	Staf i trajnuar; procedura të përditësuara; projekte me kritere klimatike.	Asistencë teknike, PBA, donatorë.
39	Integrimi i masave prioritare në PBA dhe përgatitja e projekt-fishave për financim.	Financim dhe planifikim	Shumë i lartë	2027 - 2036	Bashkia Patos, financa, projektet	Masa të buxhetuara; projekt-fisha të përgatitura; aplikime të dorëzuara.	PBA, FZHR, fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

40	Raportimi vjetor i progresit të PVP-së dhe rishikimi i planit sipas të dhënave të reja klimatike.	Monitorim dhe vlerësim	Shumë i lartë	Çdo vit	Bashkia Patos, Këshilli Bashkiak	Raport vjetor i publikuar; masa të përditësuara; rekomandime për vitin pasardhës.	Buxheti bashkiak, asistencë teknike.

11. Shtojcat orientuese

Ky kapitull është organizuar duke përdorur shtojca të plota orientuese për: procesin e konsultimit, parashikimet klimatike, integrimin e cenueshmërisë dhe riskut, kriteret e pikëzimit, listën e masave të përshtatjes dhe metodologjinë e prioritizimit. Këto shtojca shërbejnë si instrument pune për Bashkinë Patos gjatë zbatimit, monitorimit dhe rishikimit të Planit Vendor të Përshtatjes. Ato duhet të përditësohen çdo vit me të dhënat më të fundit nga IGJEO, INSTAT, AKMC, AKM, ASIG, Bashkia Patos, njësitë administrative dhe sektorët teknikë.

Shtojca 1. Procesi i konsultimit dhe angazhimit të palëve të interesit

Procesi i konsultimit për Planin Vendor të Përshtatjes 2027-2036 duhet të organizohet në disa hapa: ngritja e grupit teknik, identifikimi i palëve të interesit, mbledhja e të dhënave, konsultimet me njësitë administrative, diskutimet me sektorët teknikë, konsultimi publik, reflektimi i komenteve dhe paraqitja për miratim në Këshillin Bashkiak. Në çdo fazë duhet të dokumentohen pjesëmarrësit, çështjet e ngritura, rekomandimet dhe vendimet e marra.

Tabela 12.1. Qasja e palëve të interesit për përgatitjen e Planit të Patosit

Nr.	**Faza**	**Aktivitetet dhe qëllimi**
1	Ngritja e grupit teknik	Caktimi i pikës së kontaktit për klimën dhe përfaqësuesve nga emergjencat, planifikimi, financa, bujqësia, mjedisi, shërbimet publike, arsimi, shëndetësia dhe njësitë administrative.
2	Mbledhja e të dhënave	Grumbullimi i të dhënave për popullsinë, asetet kritike, ngjarjet e kaluara, dëmet, kanalet, rrugët, objektet publike, bujqësinë, pyjet dhe mjedisin.
3	Konsultime territoriale	Takime në Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie për verifikimin e pikave të përmbytjes, thatësirës, zjarreve, rrëshqitjeve, ndotjes dhe problemeve të shërbimeve.
4	Konsultimi i draftit	Publikimi i draftit, mbledhja e komenteve, reflektimi i tyre dhe përgatitja e versionit për miratim në Këshillin Bashkiak.

Shtojca 2. Integrimi i vlerësimeve të cenueshmërisë dhe riskut

Tabela 12.2. Shkalla orientuese e ndjeshmërisë dhe cenueshmërisë		
Pikëzimi	**Niveli**	**Përkufizimi për Patosin**
1	I ulët	Ndikim i kufizuar, dëme të vogla, ndërprerje të vogla shërbimi dhe kapacitet i mjaftueshëm për reagim.
2	Mesatar	Ndikim në disa komunitete, shërbime ose asete, me nevojë për ndërhyrje të organizuar dhe fonde të kufizuara.
3	I lartë	Ndikim i rëndësishëm në popullsi, bujqësi, infrastrukturë ose mjedis; kërkon masa të menjëhershme dhe koordinim ndërinstitucional.

Shtojca 3. Kriteret e pikëzimit të riskut

Tabela 12.3. Kriteret e pikëzimit të riskut		
Pikëzimi	**Ndikimi**	**Mundësia**
1	Dëme të vogla, ndikim i kufizuar në shërbime, pak ose aspak ndikim në shëndet dhe mjedis.	Ngjarja ka pak gjasa të ndodhë ose ndodh rrallë në territorin e Patosit.
2	Dëme të moderuara, ndërprerje e pjesshme e shërbimeve, ndikim mbi disa komunitete ose sektorë.	Ngjarja ka gjasa të ndodhë në periudha të caktuara, sidomos gjatë reshjeve intensive ose verës së thatë.
3	Dëme të larta, rrezik për shëndetin/jetën, ndërprerje shërbimesh, humbje ekonomike dhe ndikim mjedisor të rëndësishëm.	Ngjarja po ndodh ose ka shumë gjasa të rritet nga ndryshimet klimatike.

Shtojca 4. Lista orientuese e masave të përshtatjes sipas sektorëve

Tabela 12.4. Lista orientuese e masave të përshtatjes		
Sektori	**Veprimi**	**Afati**
Qeverisja	Krijimi i grupit drejtues, pikës së kontaktit për klimën dhe sistemit vjetor të raportimit.	Afatshkurtër
Infrastruktura	Hartëzim i përmbytjeve, rehabilitim kanalesh, kontroll i tombinove, urave dhe rrugëve kritike.	Afatshkurtër-afatmesëm
Bujqësia dhe uji	Program për ujitje eficiente, analiza toke, kultura rezistente dhe menaxhim të thatësirës.	Afatmesëm

Mjedisi dhe pyjet	Ripyllëzim, breza mbrojtës, zgjidhje bioinxhinierike kundër erozionit dhe kontroll i zjarreve.	Afatmesëm-afatgjatë
Shëndeti dhe komuniteti	Protokolle për valët e të nxehtit, evakuim, komunikim publik dhe asistencë për grupet e cenueshme.	Afatshkurtër-afatgjatë

Shtojca 5. Metodologjia dhe kriteret për prioritizimin e masave të përshtatjes

Prioritizimi i masave vlerësohet për përfitimet e përbashkëta dhe lehtësinë e zbatimit. Përfitimet e përbashkëta përfshijnë zhvillimin socio-ekonomik, uljen e riskut, mbrojtjen e shëndetit, përmirësimin mjedisor dhe kontributin në zbutjen e emetimeve. Lehtësia e zbatimit vlerëson kërkesat institucionale, teknike dhe financiare. Çdo nënkategori vlerësohet si e ulët, mesatare ose e lartë dhe shndërrohet në pikë 1, 2 ose 3. Masat me ndikim të lartë, kosto të arsyeshme, përgjegjësi të qarta dhe përfitime të shumëfishta klasifikohen si "Shumë të larta"; masat me ndikim të rëndësishëm por kërkesa më të mëdha financiare klasifikohen si "Të larta"; ndërsa masat që kërkojnë më shumë studim ose burime klasifikohen si "Mesatare".

Kriteri	Përshkrimi
Urgjenca	Masa trajton një risk që tashmë po ndodh ose mund të shkaktojë dëme të mëdha brenda periudhës afatshkurtër.
Ndikimi social	Masa mbron jetën, shëndetin, grupet e cenueshme, shërbimet publike dhe aksesin në infrastrukturë.
Ndikimi ekonomik	Masa ul humbjet ekonomike, mbron bujqësinë, bizneset, asetet publike dhe investimet.
Ndikimi mjedisor	Masa përmirëson cilësinë e ujit, tokës, ajrit, biodiversitetin ose zvogëlon ndotjen.
Realizueshmëria	Masa ka kosto të arsyeshme, përgjegjësi të qarta, mundësi financimi dhe kapacitete për zbatim.

Shtojca 6 Matrica e përgjegjësive

Institucioni	**Përgjegjësitë kryesore**
Kryetari i Bashkisë	Udhëheqja politike dhe sigurimi i financimit
Këshilli Bashkiak	Miratimi i planit dhe monitorimi

Drejtoria e Territorit dhe Emergjencave	Koordinimi i përgjithshëm
Emergjencat Civile	Paralajmërimi, reagimi dhe raportimi
MZSH	Menaxhimi i zjarreve
Sektori i Bujqësisë	Ujitja, kullimi dhe mbështetja për fermerët
Sektori i Mjedisit	Monitorimi mjedisor dhe ripyllëzimi
Drejtoria e Financave	Integrimi në PBA dhe financimi
Njësitë Administrative	Raportimi lokal dhe komunikimi me komunitetin
AKMC	Mbështetje teknike kombëtare
AKM	Monitorimi mjedisor
ASIG	Hartat dhe GIS

DRAFT

Shtojca 7 Hartat bazë

Harta 1. Vendndodhja e Bashkisë Patos në Shqipëri dhe Qarkun Fier


HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E BASHKIVE TE SHQIPERISE
N



Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

Harta 2. Ndarja administrative e Bashkisë Patos



Harta 3. Përdorimi i tokës



Harta 4. Harta e përmbytjeve



Harta 5. Harta e rrezikut nga zjarret



Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

Harta 6. Harta e rrëshqitjeve dhe erozionit



Harta 7. Shpërndarja e popullsisë



Harta 8. Harta e pronës publike



Harta 9. Rrjeti rrugor kryesor dhe dytësor



Harta 10. Rrjeti i ujitjes dhe kullimit



Harta 11. Infrastruktura energjetike



Harta 12. Harta e Cenueshmërisë Klimatike të Bashkisë Patos


HARTA E PRIORITETIZIMIT TË RREZIKUT MULTI-FAKTOR, BASHKIA PATOS
BASHKIA ROSKOVEC
BASHKIA FIER
Risk Klasifikimi
Ulët
Mesatar
Lartë
Shumë i lartë
Të dhënat e integruara
Përmbytjet
Thatësirat
Zjarret
Rrëshqitjet
Objektet kritike
Popullsia
Infrastruktura
Bashkitë kufizuese
Fier
Roskovec
Mallakastër
Elementet bazë
Rrugët
Hekurudha

12. Referenca kryesore

- Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore, “Parashikimi Hidrologjik dhe Meteorologjik”, 2026.
- Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), “Buletini mbi Rreziqet Natyrore”, botime ditore 2025-2026.
- Instituti i Statistikave (INSTAT), “Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023”, publikimet kombëtare, qark/bashki dhe rezultatet kryesore.
- Këshilli i Ministrave, VKM nr. 432, datë 10.06.2026, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036”.
- UNDP Albania, “Albania’s National Adaptation Plan 2026-2036”, 2026.
- UNDP Albania, “Local Adaptation Plans”, 2026.
- Bashkia Patos, “Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Patos” dhe dokumentacioni shoqërues i planifikimit territorial, i përdorur për të dhënat mbi strukturën hapësinore, përdorimin e tokës, vendbanimet, infrastrukturën, zonat urbane/rurale dhe orientimet e zhvillimit vendor.
- Bashkia Patos, “Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, i përdorur për prioritetet buxhetore, investimet publike, shërbimet bashkiake, infrastrukturën, gjelbërimin, ujitjen/kullimin, mbetjet, energjinë dhe mbrojtjen civile.
- Bashkia Patos, “Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2024-2030”, e përdorur për identifikimin e rreziqeve, strukturat përgjegjëse, hartëzimin e ekspozimit, masat parandaluese dhe koordinimin institucional.
- Bashkia Patos, “Plani Vendor për Emergjencat Civile 2024-2030”, i përdorur për të dhënat mbi gatishmërinë, reagimin, evakuimin, strukturat operative, pikat kritike dhe procedurat për emergjencat klimatike e natyrore.
- Bashkia Patos, “Raporti i Vlerësimit të Riskut në Shkallë Vendore për Bashkinë Patos”, i përdorur për hartat dhe informacionin mbi përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet, riskun teknologjik, rrezikun biologjik, infrastrukturën kritike dhe ekspozimin e popullsisë.
- Bashkia Patos, “Draft Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2026-2030”, i përdorur për të dhënat mbi grumbullimin, transportin, minimizimin, riciklimin, kompostimin, pikat problematike, ndërgjegjësimin dhe ndikimin e mbetjeve në përmbytje e ndotje.
- Bashkia Patos, “Plani Social 2025-2028”, i përdorur për identifikimin e grupeve të cenueshme, familjeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, fëmijëve në risk, grave në situatë kritike dhe shërbimeve sociale të nevojshme gjatë emergjencave klimatike.
- Bashkia Patos, “Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027”, i përdorur për të dhënat mbi tokën bujqësore, kulturat bujqësore, drufrutorët, blegtorinë, agropërpunimin, ujitjen, kullimin, problematikat e fermerëve dhe masat për bujqësi reziliente.

DRAFT

- Bashkia Patos, “Plani Lokal për Zhvillimin e Turizmit 2026-2031”, i përdorur për të dhënat mbi asetet natyrore, kulturore dhe historike, potencialin e agroturizmit, destinacionet lokale, peizazhin, trashëgiminë dhe mundësitë për diversifikim ekonomik.
- Bashkia Patos, “Raporti i Vlerësimit të Kapitalit Natyror për Bashkinë Patos”, i përdorur për të dhënat mbi burimet ujore, rezervuarët, pyjet, tokën, biodiversitetin, peizazhin, burimet natyrore dhe potencialin energjetik.
- Bashkia Patos, dokumentet dhe njoftimet vendore për konsultimet publike, projektet komunitare, tranzicionin e energjisë, shërbimet publike, arsimin, shëndetësinë, njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdie dhe raportimet periodike të bashkisë, të përdorura për verifikimin e të dhënave sektoriale dhe institucionale.

DRAFT